




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



**STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË
KUFIRIT**



P Ë R M B A J T J A

SHKURTESAT.....	6-7
-----------------	-----

KAPITULLI I

HYRJE	8-9-10
1. KONCEPTI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT.....	10-11
1.1 Tri shtyllat kryesore që mbështesin konceptin MIK të BE-së	12
1.2 Bashkëpunimi brenda agjencisë.....	12
1.3 Bashkëpunimi ndërmjet agjencive	12-13
1.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar	13
2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË	14
2.1 Parametrat e Strategjisë	14
2.2 Objektivat	15-16
2.3 Parimet e përmbushjes së objektivave.....	17

KAPITULLI II

3. VËSHTRIM POLITIK, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE TOPOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	18
3.1 Territori i Republikës së Kosovës	19
3.2 Të dhënat gjeografike	19
3.3 Të dhënat topografike	20
3.4 Pikat e kalimit kufitar, numri, llojet, kategorizimi dhe standardizimi	20-21
3.5 Kategorizimi dhe standardizimi i PKK-ve	22
3.6 Kufiri i gjelbër dhe i kaltër	23

KAPITULLI III

4. ORGANET INSTITUCIONALE	24
4.1 Ministria e Punëve të Brendshme (Policia Kufitare)	25-26
4.2 Ministria e Financave (Dogana e Kosovës).....	26-28
4.3 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.....	28-29

4.4 Agjencitë dhe organet tjera të Republikës së Kosovës të përfshira në MIK	30
--	----

KAPITULLI IV

5. AUTORITETI BASHKËRENDUES	31
5.1 Detyrat e organit mbikëqyrës dhe vendimmarrës dhe Bordit Ekzekutiv për MIK	32
5.2 Detyrat e grupit implementues.....	33
5.3 Detyrat e Sekretariatit të MIK-ut.....	34
5.4 Mjetet buxhetore	34

KAPITULLI V

6. BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I TRI SHTYLLAVE TË MIK	35-36
6.1 BASHKËPUNIMI BRENDA AGJENCISË	37
6.1.1 Policia Kufitare	37
6.1.1.1 Korniza ligjore	37
6.1.1.2 Organizimi dhe menaxhimi	37
6.1.1.3 Procedurat	38
6.1.1.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	39
6.1.1.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	39
6.1.1.6 Infrastruktura dhe pajisjet	40
6.1.2 Dogana e Kosovës	41
6.1.2.1 Korniza ligjore	41-42
6.1.2.2 Organizimi dhe menaxhimi	42-43
6.1.2.3 Procedurat	43-44
6.1.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	44-45
6.1.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	45-47
6.1.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet	47
6.1.3 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës	48
6.1.3.1 Korniza ligjore	48
6.1.3.2 Organizimi dhe menaxhimi	48
6.1.3.3 Procedurat	49

6.1.3.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	49-50
6.1.3.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	50-51
6.1.3.6 Infrastruktura dhe pajisjet	51
6.2 BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCIVE	52
6.2.1 Korniza ligjore	52-53
6.2.2 Organizimi dhe menaxhimi	53
6.2.3 Procedurat	54
6.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	54-55
6.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	56-57
6.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet	57-58
6.3 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	59
6.3.1 Policia Kufitare	59
6.3.1.1 Korniza ligjore	59
6.3.1.2 Organizimi dhe menaxhimi	60
6.3.1.3 Procedurat	60-61
6.3.1.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	61-62
6.3.1.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	62
6.3.1.6 Infrastruktura dhe pajisjet	63
6.3.2 Dogana e Kosovës	64
6.3.2.1 Korniza ligjore	64-65
6.3.2.2 Organizimi dhe menaxhimi	65-66
6.3.2.3 Procedurat	66
6.3.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	66-67
6.3.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	67-69
6.3.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet	69
6.3.3 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	70
6.3.3.1 Korniza ligjore	70
6.3.3.2 Organizimi dhe menaxhimi	70-71

6.3.3.3 Procedurat	71
6.3.3.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi	71
6.3.3.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	72
6.3.3.6 Infrastruktura dhe pajisjet	72-73

KAPITULLI VI

7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E VIZAVE, AZILIT DHE MIGRIMIT NË KONTEKSTIN E MIK-ut.....	74
7.1 Vizat	75-76
7.2 Azili dhe migrimi	76

KAPITULLI VII

8. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RISHIKIMI.....	77-79
SHTOJCAT.....	80
Struktura organizative e Policisë së Kosovës	81
Struktura organizative e Doganës së Kosovës	82
Struktura organizative e AUV-së	83
Struktura e bashkëpunimit dhe bashkërendimit për MIK.....	84
Korniza ligjore	85-86
Vendimi i Qeverisë dhe lista e shteteve që kërkohet vizë për të hyrë në RKS	87-90

SHKURTESAT

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"
ANT	Analiza e Nevojave për Trajnim
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AKSP	Akademia Kosovare për Siguri Publike
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ASYCUDA World	Sistem i TI-së në Doganën e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMS	Sistem i TI-së në Policinë Kufitare
C-TPAT	Partneriteti Tregtar Doganor Kundër Terrorizmit
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër
CVED	Dokumenti hyrës unik veterinar
DHM	Drejtoria për të Huaj dhe Migracion
DMCP	Misionet Diplommatike dhe konsullatat
DKAM	Departamenti për Kufij, Azil dhe Migracion
DK	Dogana e Kosovës
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DOH	Drejtoria e Operimit të Hyrave
EUOK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
EWS	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
FAO	Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin
FRONTEX	Agjencia e Bashkimit Evropian
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
IPP	Informatat Paraprake për Pasagjerë
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
ILO	Oficeri Ndërlidhës për Migrim
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IHR	Rregulloret Ndërkombëtare për Shëndet
ICS	Stacionet e Brendshme për Kontroll
IPPC	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve
KFOR	Forca e Kosovës
KE	Komisioni Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KSO	Korniza Strategjike Operative
LVUK	Laboratori i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme

MI	Ministria e Infrastrukturës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OIE	Organizatë Ndërkombëtare e Epizootive
OAE	Operatori i Autorizuar Ekonomik
PKK	Pikë Kalimi Kufitar
PIK	Pika Inspektuese Kufitare
PK	Policia Kufitare
PSO	Procedura Standarde Operative
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
SIS	Sistemi i Informacionit Shengen
SIPK-së	Sistemi Informativ i Policisë Kosovës
SANCO	Drejtoria e Përgjithshme për Shëndetësi dhe Mbrojtje të Konsumatorit
SELEC	Qendra për Zbatim të Ligjit e Jug-Lindjes
TAIEX	Asistenca Teknike e Njësisë së Shkëmbimit të Informacioneve
TI	Teknologjia Informative
TeR	Termet e Referencës
TRACES	Kontrolli i Tregtisë dhe Sistemi i Eksportit
UA	Udhëzimet Administrative
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
WCO	Organizata Botërore e Doganave
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë
WORLD BANK	Banka Botërore
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZD	Zyra Doganore
ZBD	Zyrat e Brendshme Doganore

KAPITULLI

I

HYRJE

1. KONCEPTI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT

2. PËRPARËSITË DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Hyrje

Republika e Kosovës ka përcaktuar qartë vizionin dhe interesat e saj dhe njëkohësisht do të përcjellë dhe zbatoj me përkushtim të gjitha proceset demokratike, ekonomike, sociale, politike dhe reformat institucionale në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe në integrimet euroatlantike.

Menaxhimi i Integruar i Kufirit dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të veçantë në raport me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi, veprimet politike dhe Sigurinë Kombëtare brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat tjera ndërkombëtare dhe ndërtimin e besimit me shtetet fqinje e më gjerë.

Përafrimi dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian për Republikën e Kosovës është një orientim dhe objektiv strategjik, që nënkupton pranimin e vlerave evropiane dhe njëkohësisht aprovim i standardeve më të larta sektoriale. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave është një element kyç që bazohet BE, e cila bën thirrje për futjen e masave dhe standardeve të kontrollave të kufijve. Bashkimi Evropian ka zhvilluar një sistem efektiv të kontrollit dhe menaxhimit kufitar, të cilat lejojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave, parandalimin e krimit ndërkufitar gjithmonë duke respektuar standardet e larta të drejtave dhe lirive të njeriut.

Zbatimi i konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit është gjithashtu një tregues i qartë për partnerët ndërkombëtarë që Republika e Kosovës është e gatshme të kontribuojë për sigurinë rajonale dhe më gjerë, duke u bërë një partner i besueshëm si për BE-në dhe të tjerët, në sferën e kontrollit të kufijve të saj.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në procesin e zhvillimit të një Strategjie Kombëtare për MIK, mori në konsideratë situatën socio-politike dhe sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe të rajonit, krahasoj përvojat e vendeve të tjera në këtë fushë, transformimin e bërë në këtë proces, pranoj dhe adaptoj në Strategjinë për MIK 2013-2018, të gjithë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për çështje të menaxhimit kufitar: Ligjin për Kontroll të Kufirit dhe Ligjin për Bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, dhe po ashtu dokumentet strategjike si: Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2768 Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, mbajtur në Bruksel), Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në bashkëpunim e jashtëm të KE 2009, rekomandimet e dala nga Katalogu i Shengenit lidhur me kontrollin e kufijve të jashtëm, kthimin dhe ripranimin e BE-së, (rekomandimi i këshillit të BE-së 7864/09), Kodi i Shengenit për Kufij (Rregullorja Nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e një Kodi të Komunitetit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përgjatë kufijve), Traktatin e Lisbonës, kriteret bazë të dokumentit të Kopenhagës, Dokumentin EU Blueprint për Dogana, kërkesat në fushën e ekonomisë dhe tregtisë, standardet tjera të BE-së,) dhe Rregullorja (KE) Nr.

810/2009 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009 për krijimin e një Kodi të Komunitetit për Viza (Kodi i Vizave) dhe praktikat më të mira të BE-së.

Duke përdorur përvojën nga praktikat më të mira që zbatohen në BE, Republika e Kosovës bën përpjekje për të tejkaluar sistemin e pengesave ekzistuese dhe në përputhje me specifikat e veta do të caktoj prioritetet për veprim dhe do të ndërmer hapa gjithëpërfshirës dhe radikal për ndryshime së bashku me agjencitë kufitare në përputhje të plotë me rregullat dhe standardet e BE-së.

Strategjia dhe Plani i Veprimet për MIK janë dokumente fleksibile të cilat mund të plotësohen dhe ndryshohen në vazhdimësi në aspektin e zbatimit gradual të parametrave, objektivave, veprimeve dhe proceseve të punës, në sferën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve duke iu përshtatur rregullave dhe mundësive në përputhje me gjendjen në terren, interesat strategjike të Republikës së Kosovës dhe ndryshimeve brenda standardeve të BE-së.

1. KONCEPTI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT

Koncepti i BE-së për MIK nënkupton: Bashkëpunimin dhe bashkërendimin kombëtar dhe ndërkombëtar midis të gjitha autoriteteve përkatëse dhe agjencive të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë për të vendosur (krijuar) menaxhim kufitar efektiv, efikas dhe të bashkërenduar (koordinuar) në mënyrë që të arrihet objektivi: **për kufij të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt** ".

Një model i përgjithshëm për menaxhimin e kufijve të Republikës së Kosovës që është në përputhje me menaxhimin e kufijve Evropian është i rëndësishëm për ruajtjen e sigurisë së brendshme, për parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe për aspektet tjera të kimit ndërkufitar dhe për të mundësuar/ siguruar kalime kufitare të papenguara për udhëtarët legjitim. Koncepti i MIK në Republikën e Kosovës, është zhvilluar në atë mënyrë që të siguroj menaxhim të kufijve të Republikës së Kosovës, në formë efikase, gjithëpërfshirëse me një kosto-efektive ku në të ardhmen poashtu edhe për kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian.

Koncepti i Republikës së Kosovës për MIK dhe koncepti i BE për MIK përfshijnë të gjitha masat që kanë të bëjnë me linjat e veprimit (politikën), legjislacionin, bashkëpunimin sistematik, ndihmën reciproke (shpërndarjen e barrës), personelin, pajisjet dhe teknologjinë, të marra në nivele të ndryshme nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës, duke vepruar në bashkëpunim dhe kur është e nevojshme së bashku me akterë tjerë, duke ushtruar së bashku modelin katër qasje të kontrollit dhe analizën e integruar të rrezikut.

Menaxhimi i kufijve duhet të plotësojë tri objektiva, të cilat janë po aq të domosdoshme dhe plotësisht në përputhje me njëra-tjetrën:

- Mbrojtja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi i lëvizjes (fluksit) të migrimit me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt, krimit të ndërlidhur dhe formave tjera të krimit ndërkufitar;
- Kalime kufitare të papenguara dhe të shpejta për shumicën e udhëtarëve të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloret përkatëse;
- Respektim i plotë i të drejtave themelore, duke përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin njerëzor dhe duke lejuar qasje në mbrojtje ndërkombëtare për ata që janë në nevojë.

Menaxhimi i Integruar i Kufijve, është një koncept që përbëhet nga dimensionet e mëposhtme bazuar në Rregulloren Nr. 562/2006 të Komisionit Evropian, e publikuar nga Këshilli i BE-së për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme.

- Kontrolli kufitar (kontrollimet dhe mbikqyrja), siç përcaktohet në Kodin e Shengenit për Kufij, duke përfshirë analizën e riskut dhe inteligjencës kriminale.
- Zbulimi dhe hetimi i krimit ndër-kufitar në bashkërendim (koordinim) me të gjitha autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit.
- Bashkërendimi dhe koherenca e aktiviteteve të shteteve anëtare dhe institucioneve dhe organeve tjera të Komunitetit dhe Bashkimit.
- Bashkëpunimi ndërmjet agjencive për menaxhimin e kufirit (rojeve kufitare, doganës, policisë, sigurisë kombëtare dhe autoriteteve tjera relevante) dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Modeli katër-qasje i kontrollit (masat që ndërmerren në vendet e treta, bashkëpunimi me vendet fqinje, kontrolli kufitar, masat e kontrollit brenda zonës së lëvizjes së lirë, duke përfshirë kthimin).

Thënë thjesht, dy dimensionet e para përshkruajnë se çfarë duhet të bëhet (kontrolli kufitar, analiza e riskut, inteligjenca kriminale, zbulimi dhe hetimi i krimit ndërkufitar), ndërsa dy dimensionet tjera përshkruajnë se si kjo duhet të bëhet (përmes bashkërendimit, koherencës, bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe dimensionit i fundit thekson se ku ajo duhet të bëhet). Republika e Kosovës do të përmbush konceptin e MIK-ut duke i shfrytëzuar masat e brendshme, gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin ekzistues dhe të ardhshëm, legjislacionin sekondar, PSO-të dhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.

MIK-u parashikon bashkëpunimin dhe bashkërednimin ndërmjet gjithë akterëve të përfshirë në menaxhimin e kufirit. Duke përmirësuar komunikimin, shkëmbimin e informacionit dhe përmes ndihmës reciproke dhe në mes të shërbimeve, kufiri shtetëror mund të menaxhohet shumë më suksesshëm.

1.1 Tri shtyllat kryesore që mbështesin konceptin MIK të BE-së

Aspektet kyçe të konceptit MIK, janë bashkërendimi dhe bashkëpunimi që mbështeten mbi tri shtyllat në vijim:

- Bashkëpunimi brenda agjencisë (brenda një shërbimi ose ministrie);
- Bashkëpunimi ndërmjet agjencive (midis ministrive të ndryshme apo agjencive kufitare); dhe
- Bashkëpunimi ndërkombëtar (me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare).

1.2 Bashkëpunimi brenda agjencisë

Bashkëpunimi brenda agjencisë/shërbimit i referohet procedurave, shkëmbimit të informacionit dhe burimeve brenda një ministrie ose agjencie. Kjo përfshinë:

- (a) bashkëpunimin vertikal: mes niveleve qendrore, rajonale dhe lokale dhe
- (b) bashkëpunimin horizontal: midis njësive të ndryshme të njëjtave nivele.

Të dy format e lartpërmendura të bashkëpunimit kërkojnë një ndarje të qartë të përgjegjësisë, komunikim aktiv dhe shkëmbim të rregullt të informacioneve.

Bashkëpunimi brenda shërbimit/agjencisë i referohet ndërveprimit në mes:

- Një ministrie përkatëse dhe agjencisë së saj për menaxhimin e kufirit.
- Agjencisë kufitare dhe shërbimeve tjera brenda të njëjtës ministri.
- Njësive të ndryshme brenda Drejtorisë së Përgjithshme.
- Njësive të ndryshme lokale: pikave të kalimit kufitar (PKK), pikave inspektuese kufitare (PIK), pikave të përcaktuara hyrëse dhe stacioneve të brendshme të kontrollit.
- Shtabeve, njësive rajonale dhe PKK-ve lokale dhe stacioneve të brendshme të kontrollit.

Bashkëpunimi brenda agjencisë është gjithashtu bazë për dy shtyllat e tjera të MIK-ut, bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Pa komunikim dhe bashkëpunim efektiv brenda agjencisë/shërbimit, mundësia dhe aftësia e një shteti për të zbatuar konceptin e MIK-ut si tërësi është e kufizuar. Në qoftë se një agjenci individuale është duke mos e kryer punën si duhet, aftësia e saj për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me agjencitë e tjera është zvogëluar.

1.3 Bashkëpunimi ndërmjet agjencive

Bashkëpunimi ndërmjet agjencive i referohet bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet ministrive të ndryshme apo agjencive kufitare, si dhe mes zyrtarëve operacional të agjencive të ndryshme aktive në kufi apo zyra të brendshme të kontrollit. Ajo fillon që prej ministrisë / nivelit qendror, ku strategjitë afatmesme dhe afatgjate janë diskutuar dhe shtrihet në kontaktet operative në nivel të drejtorive rajonale dhe deri te operacionet e ditëpërditshme në PKK. Bashkërendimi

(koordinimi) në nivel strategjik ndihmon në shmangien e mospërputhjeve të politikave/linjave të veprimit, veçanërisht në nivel lokal, ku bashkëpunimi ndër-agjenci duhet të shpie deri te një menaxhim më efikas i fluksit të punës, shkurtim të afatit/kohës së procesimit (përpunimit) dhe zbulim më të madh të rasteve të aktiviteteve të paligjshme ndër-kufitare siç janë migrimi i parregullt dhe kontrabanda e mallrave dhe kafshëve.

Edhe pse përgjegjës për aspekte të ndryshme të menaxhimit të kufijve, të gjitha agjencitë e menaxhimit të kufirit ndajnë të njëjtat qëllime kryesore:

- Mbrojtjen kundër kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare, rendit, ekonomisë dhe shëndetit publik.
- Parandalimin e krimit ndër-kufitar dhe parregullsive.
- Lehtësimin e lëvizjeve të ligjshme ndërkufitare.

Në mënyrë që të përmbushen këto objektiva, të gjitha agjencitë e përfshira duhet të bashkëpunojnë, shkëmbejnë informacion dhe bashkërendojnë punën e tyre.

1.4 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi më i afërt ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të kufirit nënkupton bashkëpunimin me vendet fqinje dhe vendet e tjera relevante, si dhe me organizatat relevante rajonale / ndërkombëtare të tilla si Frontex, OBD, UNODC, UNCTAD, UNHCR, ose IOM, është një mjet efektiv për të lehtësuar qarkullimin dhe tregtinë legjitime ndër-kufitare dhe në të njëjtën kohë për të luftuar krimin ndërkufitar dhe migrimin e parregullt. Përderisa niveli qendror përqendrohet në bashkërendimin e aspekteve strategjike të tilla, si mbrojtja dhe mbikëqyrja e përbashkët e sektorëve kufitar më me rrezik, bashkëpunimi në nivel rajonal dhe lokal përqendrohet në çështjet e përditshme operacionale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë aspekt i referohet bashkëpunimit:

- ndërmjet shteteve fqinje që mbulojnë çështje të ndryshme, të tilla si organizimi i patrullave të përbashkëta ose bashkërendimi i mbikëqyrjes kufitare, pikave të përbashkëta kufitare, shkëmbimit të informacionit, analizave të përbashkëta të rrezikut, trajnimit të përbashkët, zyrat e përbashkëta të kontaktit dhe pikat e kontaktit.
- Në nivelin shumëpalësh, për një qasje më të mirë të fushat e përbashkëta të punës të tilla si: krimi ndërkufitar, migrimi i parregullt, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe kontrabandimi i mallrave, nëpërmjet bashkëpunimit me akterët ndërkombëtarë, pjesëmarrja në forume rajonale/ ndërkombëtare dhe përmes nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
- Në nivel lokal në mes të zyrtarëve në të dy anët e kufirit.

2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Qëllimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është zhvillimi i një sistemi të mbrojtur dhe të sigurt të kufijve i cili do t'i integrojë të gjitha agjencitë e autorizuar për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror, përmes aplikimit të drejtë të dimensioneve të MIK-ut të parapara në Kodin e Shengenit për Kufij (Rregulloren Nr. 562/2006 të Komisionit Evropian) dhe Katalogun e Shengenit të BE-së lidhur me kontrollin e kufijve të jashtëm dhe kthimin dhe ripranimin, e veçanërisht modelit katër qasje të kontrollit.

Bazuar në nevojën për të dy aspektet, si për bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar (lokal, dypalësh dhe shumëkombësh), Republika e Kosovës përkushtohet që hap pas hapi të zbatoj modelin katër qasje të kontrollit që është një element thelbësor i MIK-ut në Katalogun e Shengenit të BE-së për Kontrollin e Kufijve të Jashtëm dhe Kthimin dhe ripranimin.

Ky model përbëhet prej një sërë masash plotësuese të cilat duhet të zbatohen në katër nivele të ndryshme:

- Masat në vendet e treta,
- Bashkëpunimi me vendet fqinje,
- Kontrolli kufitar, dhe
- Masat e kontrollit brenda zonës së lëvizjes së lirë, duke përfshirë kthimin.

2.1 PARAMETRAT E STRATEGJISË

Veprimet e Qeverisë për të garantuar kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt duhet të përqendrohen në parametrat si në vijim:

- Korniza ligjore,
- Organizimi dhe menaxhimi,
- Procedurat,
- Burimet njerëzore dhe trajnimi,
- Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit,
- Infrastruktura dhe pajisjet,
- Buxheti.

2.2 OBJEKTIVAT

- Zbatimi i legjislacionit përkatës për të tri shtyllat që garantojnë se agjencitë e autorizuar për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror do të organizohen dhe të funksionojnë sipas standardeve të BE-së.
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të agjencive të përfshira në kufi si dhe reformimi në strukturën e tyre organizative dhe menaxhuese.
- Të gjitha procedurat e agjencive të kufirit lidhur më burimet njerëzore, trajnimet, financat dhe logjistikën përcaktohen me rregulloret e brendshme me konsultime të përbashkëta ndërmjet tyre. Procedurat adekuate të përzgjedhjes dhe të emërimit të personelit në agjencitë e kufirit të zbatohen me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe cilësisë.
 - Kompetenca e personelit në kufi është thelbësore për cilësinë e shërbimit të kryer. Prandaj është e rëndësishme që të organizohen dhe mbahen trajnime specifike mbi detyrat që ndërlidhen me kufirin dhe se stafi kompetent të rekrutohet në bazë të kriterëve objektive. Detyrat e menaxhimit të kufirit janë shumë të specializuara, të cilat duhet të reflektohen në planet e trajnimit si atë bazik dhe të avancuar si në aspektin teorik dhe praktik, të bazuar në trajnim në klasë si dhe atë në vend të punës, duke qenë i plotësuar nga stërvitjet dhe mentorimin (këshillimin) në këtë fushë.
 - Trajnimi duhet të jetë një element i vazhdueshëm për stafin në të gjithë karrierën e tyre (trajnim rifreskues, specializues dhe për mësim të aftësive/ informacioneve të reja/ dhe të bazohet në programe dhe manuale të azhuruara rregullisht. Koncepti i MIK-ut duhet të jetë një pjesë integrale e trajnimeve. Trajnim i përbashkët i oficerëve me profile të ndryshme mund të merret në konsideratë, në mënyrë që të inkurajohen shkëmbimi i ideve. Agjencitë e kufirit duhet të kenë një strukturë të centralizuar trajnimi dhe në varësi të madhësisë dhe të burimeve të vendit - disa zyra trajnimi "satelit" ose qendra. Futja e një sistemi trajnimi të trajnuesve mund të merret në konsideratë, me të cilin më shumë trajnerë të brendshëm do të jenë në dispozicion që sa më shpejtë të përcjellin dijen (në formë kaskade) deri poshtë në nivel të terrenit.
 - Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit midis agjencive të autorizuar të kufirit duhet të përmirësohet si dhe të krijohet një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të informacioneve siç parashihet edhe në Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2768 Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, mbajtur në Bruksel), Katalogu i Shengenit lidhur me kontrollin e kufijve të jashtëm, kthimin dhe ripranimin e BE-së, rekomandimi i këshillit të BE-së 7864/09, Kodi i Shengenit për Kufij (Rregullorja Nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e një Kodi të Komunitetit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përgjatë kufijve (Kodin e Shengtit për Kufij), Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në bashkëpunim e jashtëm të KE.
 - Të gjitha agjencitë relevante kufitare do të kryejnë analiza të përbashkëta të rrezikut dhe planifikim operacional dhe do të zbatojnë procedura të përbashkëta efektive të kontrollit në mënyrë që të luftojnë krimin ndërkufitar, ndërsa do të lehtësojnë trafikun e ligjshëm.

- Zhvillimi i infrastrukturës dhe pajisjeve të përshtatshme që mbështesin përpjekjet e agjencive në mënyrë që të krijohet shërbim profesional i qytetarëve dhe përfituesve të tjerë.
- Sigurimi i fondeve të qëndrueshme për ushtrimin e vazhdueshëm të punëve në sistemin e menaxhimit të integruar të kufirit dhe krijimi i mekanizmave për sigurimin e donacioneve ndërkombëtare.
- Objektiv i Strategjisë për MIK është zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve të QKMK-së, për bashkërendim dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha agjencive përkatëse të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë në mënyrë që të krijohet menaxhim efikas, dhe i efektshëm i kufijve që do të garantojë kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.
- Objektiv tjetër me rëndësi në kontekst të MIK-ut është edhe parandalimi dhe luftimi i korrupsionit. Për shkak të natyrës së detyrave të tyre dhe bashkëveprimit të tyre të shpeshtë me publikun, agjencitë për menaxhimin kufitar janë veçanërisht të ndjeshme ndaj korrupsionit. Megjithatë, një numër i veprimeve parandaluese duhet të merret nga secila agjenci kufitare.
- Secila agjenci në kuadër të MIK-ut duhet të zhvillojë një procedurë dhe praktikë të përgjithshme për kontroll në kufi dhe në brendësi, zbatimin e të cilës duhet të mbikëqyret nga drejtoritë e përgjithshme. Procedura dhe praktikat për kontroll në kufi duhet të përcaktojnë dhe të përfshijë standardet për analizën e rrezikut dhe përzgjedhjen, kontrollet sistematike, gjithëpërfshirëse dhe fleksibile, shkëmbimin e informatave, si nga lart-poshtë dhe poshtë-lart, organet përgjegjëse për planifikim (në nivel qendror dhe lokal), bashkëpunimi me agjencitë e tjera kufitare, bashkëpunimin ndërkufitar, marrëdhëniet me tregtinë dhe publikun, menaxhimin, personelin (burimet njerëzore, kompetencat e kërkuara dhe kodet e etikës), trajnimin, objektet, pajisjet dhe teknologjinë e informacionit. Pikënisje duhet të jetë identifikimi i atyre kontrolleve që mund të lëvizin në brendësi nga kufijtë pa ndikuar negativisht në rreziqet që ato mund të paraqesin dhe ato të cilat duhet të kryhen në PKK. Objektiv është sigurimi që përparësia i është dhënë sigurisë dhe se kontrollet kryhen aty ku janë më të efektshme.

2.3 PARIMET E PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË

Në përmbushjen e objektivave të parapara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për MIK, institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet vijuese:

- **Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** – Veprimet e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë duhet të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjisllacionin në fuqi, marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe standardet e BE-së.
- **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut** - Ky parim nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë.
- **Parimi i sigurisë** - Ky parim nënkupton garantimin e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët nëpërmjet parandalimit dhe zvogëlimit të gjitha formave të krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë.
- **Parimi i prioritetit** – Parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë është prioritet për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës. Përkushtimi i përgjithshëm për t’u marrë seriozisht me këto probleme është element genësor.
- **Parimi i profesionalizmit** – Parandalimi dhe luftimi i krimit dhe akteve të kundërligjshme në kufi, ato ndërkufitare dhe më gjerë, kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme / praktika më të mira. Kjo nënkupton kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për institucionet dhe agjencitë e Republikës së Kosovës si dhe përkujdesjen për të rekrutuar vetëm specialistët e cilësisë më të mirë.
- **Parimi i vazhdimësisë** – Të gjitha aktivitetet e parapara duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme. Kjo është sidomos e rëndësishme për arsye se do të ekzistojnë përkufizimet kohore administrative/procedurale, si dhe për arsye se iniciativat /aktivitetet e ndryshme, është e nevojshme të ndërliqen në veprime të cilat do të zgjasin me vite të tëra.
- **Parimi i besueshmërisë** - Institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme duhet të kujdesen për ndërtimin e besimit në ruajtjen e integritetit të hetimeve, të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.
- **Parimi i proporcionalitetit** - Nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve dhe agjencive që merren në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe akteve të kundërligjshme, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme dhe në kohë sa më të shkurtër të mundshme.
- **Parimi i analizës dhe qasjes shkencore dhe proaktive**
Kryerja e analizave të paanshëm të fakteve dhe përditësimi i masave lidhur me zbatimin e politikës kombëtare të Kosovës në baza të rregullta,
- **Parimi i llogaridhënies, monitorimit dhe kontrollit**
Zhvillimi i raporteve të rregullta mbi situatën e përgjithshme të MIK-ut në Kosovë

KAPITULLI

II

3. VËSHTRIMI POLITIK, KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE TOPOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

3.1 Territori i Republikës së Kosovës

Territori i Republikës së Kosovës është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kufiri me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë është i shënuar, ndërsa me Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë pritet të shënjohet në të ardhmen.

3.2 Të dhënat gjeografike

Republika e Kosovës gjendet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet me: Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim, Republikën e Maqedonisë në jug, Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim, Republikën e Serbisë në veri-lindje. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror. Pozicioni gjeografik i saj është:

KOORDINATAT GJEOGRAFIKE		
Nr	Longitudo (Gjatësia)	Latitudo (Gjerësia)
Veri	20:48:42.9995	43:16:23.9901
Perëndim	20:00:52.3818	42:43:45.7964
Jug	20:37:17.5130	41:51:07.2305
Lindje	21:47:23.5206	42:39:04.4173

Sipërfaqja e Republikës së Kosovës është 10.908 km², me gjatësi të kufirit shtetëror si më poshtë:

GJATËSIA E KUFIRIT SHTETËROR SIPAS SHTETEVE RRETH KOSOVËS		
SHQIPËRI	113.551 km	
MAQEDONI	170.772 km	
MALI I ZI	79.165 km	
SERBI	380.068 km	
Gjithsejtë	743.556 km	

3.3 Të dhënat topografike

Pothuajse të gjithë kufijtë e vendit janë rural dhe malor. Relievi nëpër të cilin kalon kufiri shtetëror i Republikës së Kosovës është në përgjithësi malor. Llojet e relievit ndryshojnë, nga malor i thyer, kodrinor, fushor dhe liqenor. Kufiri tokësor duke qenë kryesisht malor vështirëson qarkullimin kufitar, sidomos në sezonin e dimrit.

3.4 Pikat e kalimit kufitar, numri, llojet, kategorizimi dhe standardizimi

Përcaktimi dhe kategorizimi i PKK-ve të trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror, është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi Nr. 02/124, datë, 10.04.2013, ku bazuar në këtë vendim, Republika e Kosovës i ka 8 PKK të kategorisë A, 6 PKK të kategorisë B dhe 3 PKK të kategorisë C.

Aktualisht në Republikën e Kosovës funksionojnë 17 PKK, prej të cilave 3 PKK janë të përkohshme: Orqushë, Krushevë/Shishtavec dhe Gllloboqicë/Borje, të cilat janë nën mbikëqyrjen e PKK Vërmicë.

Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë janë si në vijim:

- Vërmicë;
- Orqushë;
- Krushevë/Shishtavec;
- Gllloboqicë/Borje;
- Qafë e Prushit;
- Qafë e Morinës.

Pikë e Kalimit Kufitar e trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Malit të Zi, është:

- Kulla.

Pikat e Kalimit Kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë janë si në vijim:

- Bërnjak/Tabavije¹ ;
- Jarinje/Rudnicë;
- Merdarë/Merdare;
- Mutivodë/Motivode;
- Dheu i Bardhë /Konqul;
- Muçibabë/Depce.

¹ Bazuar në Protokollin teknik për zbatimin e konkluzioneve operacionale për MIK të 2 Dhjetorit 2011 dhe në Marrëveshjen e dakorduar në Bruksel me Republikën e Serbisë.

Pikat e kalimit kufitar të trafikut rrugor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë, janë si në vijim:

- Hani i Elezit;
- Gllloboqicë;
- Stanqiq-Bellanovc².

Pikë e Kalimit Kufitar të trafikut hekurudhor në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë është:

- Hani i Elezit.

Ndërsa me Republikën e Serbisë është:

- Leshaku.

Pikë e Kalimit Kufitar të trafikut ajror është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.

PRANIA E AGJENCIVE TË AUTORIZUARA PËR MIK NË PKK				
Pika e Kalimit Kufitar	POLICIA KUFITARE	DOGANA E KOSOVËS	AUV	SIPAS SHTETEVE
ANP “Adem Jashari”	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	
Vërmicë	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Shqipëri
Krushevë/Shishtavec	E pranishme			Shqipëri
Orqushë	E pranishme			Shqipëri
Gllloboqicë/ Borje	E pranishme			Shqipëri
Qafë e Prushit	E pranishme	E pranishme		Shqipëri
Qafë e Morinë	E pranishme	E pranishme		Shqipëri
Kullë	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Mali i Zi
Bërnjak	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Serbi
Jarinje	E pranishme	E pranishme		Serbi
Merdarë	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Serbi
Mutivodë	E pranishme			Serbi

² Bazuar në Marrëveshjen Ndërshtetërore Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë për PKK të përbashkët (bazuar edhe në vendimin e Qeverisë së Kosovës Prill 2013, për kategorizim të PKK-ve).

Dheu i Bardhë	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Serbi
Muçibabë	E pranishme	E pranishme		Serbi
Hani i Elezit	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Maqedoni
Glloboqicë	E pranishme	E pranishme		Maqedoni
Stanqiq/Bellanovc	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Maqedoni
Hani i Elezit (Hekurudhor)	E pranishme	E pranishme	E Pranishme	Maqedoni
Leshak (Hekurudhor)				Serbi

3.5 Kategorizimi dhe standardizimi i PKK-ve

Kriteret për kategorizimin dhe standardizimin e PKK-ve janë zhvilluar duke marrë në konsideratë vlerësimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore (marrëveshjet ndërkombëtare). Ky kategorizim është bazuar në situatën aktuale, si dhe në përmbushjen e standardeve të BE-së, siç është:

- Qarkullimi i njerëzve dhe mallrave;
- Krimi ndërkufitar;
- Migracioni dhe azili;
- Prezenca e agjencive të autorizuara në menaxhimin e integruar dhe kontrollin në kufirin shtetëror;
- Numri i personelit.

Përcaktimi i kategorive të PKK-ve është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në bazë të rekomandimit të Bordit Ekzekutiv për MIK dhe në pajtim me marrëveshjet bilaterale me shtetet fqinje. Sipas nevojës nga ana e Bordit Ekzekutiv për MIK, mund të propozohet ndryshimi i emërtimeve dhe kategorizimi i këtyre PKK-ve. Pikat e kalimit kufitar të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror sipas rëndësisë dhe veprimtarisë, kategorizohen në:

- **Kategoria A:** PKK-të e kategorisë A janë të hapura 24 orë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave. Në këto PKK, vazhdimisht janë të pranishme PK, DK dhe AUV.
- **Kategoria B:** PKK-të e kategorisë B janë të hapura 24 orë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave jo-komerciale. Në këto PKK, PK është e pranishme 24 orë, ndërsa DK dhe AUV gjatë intervaleve kohore të përcaktuara me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.
- **Kategoria C:** PKK-të e kategorisë C, janë PKK të përkohshme dhe janë të hapura për intervale të caktuara kohore. Këto PKK shërbejnë vetëm për qarkullim të personave dhe hapen në pajtim me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me marrëveshje me shtetet relevante fqinje mund të përcaktoj PKK të përkohshme, më qëllim të:

- ushtrimit të aktiviteteve kulturore, sportive, fetare, shkencore, profesionale dhe turistike;
- reagimit ndaj fatkeqësive natyrore dhe rastet emergjente;
- zbatimit të marrëveshjeve ndërkufitare;
- ushtrimit të aktiviteteve bujqësore, blegtorale apo aktivitete të tjera ekonomike.

Standardizimi i PKK-ve, ka për qëllim që PKK-të e kategorisë adekuate duhet të jenë të pajisura me objekte dhe pajisje përcjellëse për ushtrim të kontrollit kufitar sa më të sigurt dhe ekonomik.

3.6 Kufiri i Gjellbër dhe Kaltër

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës/Policia Kufitare mban përgjegjësinë për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, në bashkëpunim të drejtpërdrejt me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. KFOR-i në bashkëpunim dhe bashkërendim me PK-në aktualisht vazhdon ta mbikëqyrë vijën e gjellbër dhe kaltër me Republikën e Serbisë.

KAPITULLI

III

4. ORGANET INSTITUCIONALE

Agjencitë kryesore të Republikës së Kosovës të përfshira në MIK, duke i kategorizuar ato sipas funksionit të tyre: kontroll të personave dhe kontroll të mallrave, janë:

- Policia e Kosovës – MPB;
- Dogana e Kosovës- MF;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë- ZKM.

4.1 Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës

Në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon Policia Kufitare që është përgjegjëse për kontrollin e kufirit shtetëror, kontrollin brenda territorit të Republikës së Kosovës, lëshimin e dokumenteve të përkohshme për kalim ndërkufitar, sigurinë në aeroportet ndërkombëtare në bashkëpunim me operatorin e aeroportit dhe autoritetet relevante të autorizuara, parandalimin e akteve terroriste në partneritet me të gjitha agjencitë për zbatimin e ligjit, përcaktimin e së drejtës së çdo personi që dëshiron të hyjë apo të lëshojë Republikën e Kosovës, lidhur me kërkesat për viza dhe hyrje, mbylljen e përkohshme të kufijve, mbështetur në vendimin e Qeverisë, dhënien e autorizimit të përkohshëm për të kaluar kufirin e gjelbër dhe të kaltër.

Detyrat kryesore të Policisë Kufitare janë si në vijim:

- Kryen kontrole mbi ligjshmërinë e kërkesës së secilit udhëtar për të hyrë në vend;
- Parandalon dhe ndalon kalimin e paautorizuar të kufirit shtetëror;
- Kontrollon udhëtarë, duke përfshirë edhe kontrollet e mjeteve të transportit dhe gjësendet personale të tyre në mënyrë që të kalojnë kufirin shtetëror në përputhje me ligjet dhe aktet tjera normative në fuqi;
- Kryen, të paktën, kontrole minimale të shpejta dhe të drejtpërdrejta për: vlefshmërinë e dokumenteve që autorizojnë mbajtësin legjitim të kalojë kufirin dhe verifikojnë praninë e shenjave të falsifikimeve apo mashtrimeve;
- Marrin masat e nevojshme nëse një person përmbush kushtet për të hyrë ose për të dalë nga Republika e Kosovës;
- Përmbush detyrimet e specifikuara në marrëveshjet ndërkombëtare, drejtojnë veprimtarinë e autoriteteve të mandatuara për të hetuar për incidentet kufitare, kontrollojnë punën në lidhje me mbikëqyrjen e kufirit shtetëror;
- Parandalon dhe lufton veprimet e dhunshme ndaj rendit në kufirin shtetëror;
- Kryen detyrat policore për të huajt të specifikuara në Ligjin për të Huajt dhe në aktet nënligjore;
- Bashkëpunon në kryerjen e detyrave me organin përgjegjës për migracion dhe azil siç përcaktohet në ligjet përkatëse;
- Ndërmerr veprime të nevojshme për të menaxhuar çdo emergjencë që përfshin refugjatët dhe situatat e konfliktit të cilat rrezikojnë drejtpërdrejt rendin e kufirit shtetëror;
- Bashkëpunon në procedurat administrative të specifikuara nga dispozitat ligjore për të siguruar ruajtjen e rendit në kufirin shtetëror;
- Ushtron autoritet, mbështetur në dispozitat ligjore, për disa raste të shkeljeve të vogla;
- Mbledh, vlerëson dhe analizon informatat për kërcënime dhe rreziqe për autoritetet përkatëse.
- Kryen hetime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Struktura aktuale organizative e Policisë Kufitare

Policia Kufitare e Kosovës është pjesë e Policisë së Kosovës dhe është e organizuar në nivele: qendror dhe lokal. Niveli qendror i Policisë Kufitare është i përbërë nga Departamenti i Policisë Kufitare në kuadër të cilit ekziston: Divizioni për Kontroll dhe Mbikëqyrje të Kufirit dhe Divizioni për Menaxhim të Integruar të Kufirit.

Niveli lokal përfshinë nivelin rajonal dhe lokal të cilat përbëhen, nga:

- Drejtoria Rajonale e Veriut;
- Drejtoria Rajonale e Lindjes;
- Drejtoria Rajonale e Perëndimit; dhe
- Stacioni Policor i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (i cili është nën komandë të drejtpërdrejtë të Divizionit për Kontroll dhe Mbikëqyrje Kufitare);
- Niveli lokal përbëhet nga Stacionet Policore Kufitare (PKK) dhe Togjet Patrulluese.

Drejtoritë Rajonale Kufitare menaxhojnë dhe kontrollojnë stacionet policore të Policisë Kufitare në PKK, si dhe togjet patrulluese kufitare.

4.2 Ministria e Financave - Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës, është pjesë e administratës qendrore shtetërore në varësi të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Doganës dhe personelit doganor përkufizohen në Kodin Doganor dhe të Akcizave, aktet tjera normative në fuqi për funksionimin e administratës shtetërore dhe aktet e brendshme të Doganës.

Misioni i Doganës së Kosovës ndahet në tri misione:

4.2.1 Misioni fiskal

Misioni fiskal, është një nga misionet kryesore të Doganës së Kosovës, që konsiston në mbledhjen e taksave për buxhetin e Kosovës, të mallrave që importohen në Republikën e Kosovës si: taksa doganore, tatimit mbi vlerën e shtuar, akcizën, tatimit për lojrat e fatit, etj. Vlerësimi më i drejtë i vlerave të mallrave të importuara/eksportuara, përmes Sistemit të automatizuar të përpunimit të dhënave doganore ASYCUDA World, shërben si një e dhënë thelbësore për Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës në llogaritjen dhe vjeljen e tatimeve dhe po ashtu Agjencisë Kosovare të Statistikave për të dhënat statistikore.

4.2.2 Misioni ekonomik

Misioni ekonomik i Doganës së Kosovës merr gjithnjë e më shumë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit. Dogana, si organizëm i rëndësishëm i shtetit, duke zbatuar nivelet e ndryshme të taksave, tarifave dhe duke kontrolluar sistemin e licencave,

mbron prodhuesit vendor dhe stimulon importet për sfera të caktuara dhe inkurajon investimet e huaja në vendin tonë.

Gjithashtu, zbatimi i legjislacioni doganor sipas modelit evropian, ku vend të rëndësishëm zënë procedurat doganore për importin, eksportin, transitin e mallrave dhe procedurat doganore me ndikim ekonomik si, importit/eksportit të përkohshëm, i përpunimit të brendshëm, përpunimit të jashtëm, përpunimit nën kontroll doganor, deponimit doganor, etj, ka krijuar kushte të favorshme në zhvillimin dhe shtimin e shkëmbimeve tregtare me jashtë si dhe në stimulimin e prodhimit vendor.

4.2.3 Misioni mbrojtës

Dogana e Kosovës, si edhe ato të vendeve evropiane, një rëndësi gjithnjë e më të madhe i kushton misionit mbrojtës. Duke pasur një mbështetje ligjore të fuqishme, duke qenë e dislokuar në pikat e kalimit kufitar, duke pasur në vëzhgim zonën kufitare, si edhe duke mbajtur nën kontroll rrjetin rrugor nacional, dogana ka një mision shumë të rëndësishëm mbrojtës që shtrihet në shumë fusha të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe rendit publik si: luftimi i aktiviteve ilegale, rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare, luftimi i krimit kufitar, luftimi i trafikut të drogës, ndalimi i trafikut të jashtëligjshëm të armëve, eksplozivëve, lëndëve helmuese, luftimin e shpërlarjes së parave, etj.

Detyrat kryesore të Doganës së Kosovës janë:

- Mbikëqyrë të gjithë territorin doganor të Republikës së Kosovës lidhur me mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore;
- Mbledh të hyrat doganore;
- Mbron interesat financiare të vendit;
- Mbron ambientin;
- Mbron vendin nga tregtia e paligjshme, përderisa mbështet aktivitetet legale të bizneseve,
- Rritë konkurrencën e bizneseve në vend, përmes metodave moderne të punës të mbështetura nga një qasje e lehtë në mënyrë elektronike në mjedisin e doganës;
- Kryen kontrollin kufitar dhe brenda territorit për të lehtësuar qarkullimin e ligjshëm të mallrave;
- Merr masat e nevojshme në kufijtë e jashtëm dhe brenda territorit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat ndërkombëtare, për të mbrojtur ligjin dhe sigurinë kombëtare dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave;
- Kontrollon në përputhje me ndalesat dhe kufizimet duke mbrojtur kështu sigurinë e qytetarëve dhe të ambientit;
- Kryen procedurat doganore (lirim nga dogana) në zyrat e doganës në kufij dhe brenda territorit;
- Kryen hetime lidhur me faktet e mbledhura gjatë kontrollimit apo vëzhgimit të kufirit;
- Kryen kontrollin e pasagjerëve, mallrave dhe trafikut të makinave dhe ngarkesave që kalojnë kufirin shtetëror në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me autoritetet tjera;

- Bën mbledhjen dhe shqyrtimin e informatave të nevojshme për kryerjen e detyrave të doganës;
- Ndërmerr masa të kontrollit dhe verifikimit doganor si dhe lirimin nga dogana, kontrollin e akcizës dhe të taksave me qëllim të mbledhjes së të hyrave përkatëse;
- Bashkëpunon në sferat e tregtisë ndërkombëtare, qarkullimit monetar, sanitar, fitosanitar, veterinar dhe rregullon çështje tjera në lidhje me trafikun ndërkufitar të mallrave dhe personave;
- Përgatitjen, mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme për organet e tjera publike të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura aktuale e Doganës së Kosovës

Dogana e Kosovës është e organizuar në katër (4) drejtori, të cilat udhëhiqen nga drejtorët e drejtorive dhe menaxhohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganës. Këto katër drejtori janë:

- Drejtoria e Operimit të Hyrave -DOH;
- Drejtoria e Zbatimit të Ligjit- DZL;
- Drejtoria Ligjore- DL; dhe
- Drejtoria e Financave dhe Sistemeve –DFS.

4.3 Zyra e Kryeministrit- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është autoriteti më i lartë, e cila është përgjegjëse të mbrojtë jetën dhe shëndetin e njerëzve, duke siguruar nivel të lartë të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit me origjinë shtazore dhe bimore përfshirë edhe ushqimin për kafshë. Po ashtu, është përgjegjëse për shëndetin e kafshëve dhe bimëve nëpërmes parandalimit, luftimit dhe çrrënjësjes së sëmundjeve infektive.

Detyrat dhe përgjegjësitë e AUV-së:

Në fushën e veterinarisë dhe fitosanitarisë:

- Parandalimi, luftimi dhe eliminimi(eradikimi) i sëmundjeve infektive të kafshëve dhe bimëve;
- Mirëqenia e kafshëve;
- Kontrolli i sigurisë së ushqimit me prejardhje shtazore dhe bimore;
- Kontrolli i produkteve jo ushqimore me prejardhje shtazore dhe bimore;
- Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore dhe bimore;
- Kontrolli i i mbeturinave me orgjinë shtazore dhe bimore;
- Kontrolli i produkteve për mbrojtjen e bimëve (materie aktive konform listave të BE-së);
- Kontrolli i plehrave artificial;
- Kontrolli i materialit riprodhues të bimëve(farës, rizomeve, fidaneve, etj.);
- Kontrolli i medikamenteve veterinare, produkteve farmaceutike veterinare dhe produkteve tjera për kujdesin ndaj kafshëve;

- Do të marrë pjesë së bashku me autoritetet kompetente në kontrollin e qarkullimit e ushqimit të kafshëve si dhe të shtesave të ushqimit;
- Regjistrimi i fermave, matrikullimi i kafshëve dhe tufave, shënjimi i tufave, kontrolli i lëvizjeve të kafshëve;
- Regjistrimi i prodhuesve dhe e përpunuesve të bimëve;
- Kontrolli, ekspertiza veterinare dhe klasifikimi i (trupave) të mishit(klasifikimi i mishit);
- Ndërmerr dhe menaxhon rastet për (refuzim ose asgjësimin) e ngarkesave me origjinë shtazore dhe bimore nëse paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe të kafshëve dhe bimëve;
- Kontrollin e transitit të ngarkesave që përmbajnë shtazë, bimë dhe prodhime shtazore dhe bimore, nëse ngarkesa nuk përputhet me standardet e referuara;
- Planifikimi dhe realizimi i mostrimit, transportit të mostrave për analiza tek laboratorët e akredituar;
- Mbajtja e rregullt e shënimeve për numrin e ngarkesave dhe sasinë e mallrave që do të kontrollohen;
- Mbledhja e taksave për kontrollin zyrtar;
- Bashkëpunojë me ministritë, doganat, Policinë Kufitare dhe shërbimet e tjera;
- Bashkëpunojë me institucionet e ngjashme publike brenda dhe jashtë territorit p.sh. ministritë, universitetet, shërbimet doganore, laboratorët e akredituar etj.

AUV- detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron brenda Republikës së Kosovës dhe në PKK.

Struktura organizative e AUV-së

AUV është e organizuar në drejtori, sektorë, zyra rajonale dhe Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë.

AUV është e formuar sipas Ligjit të Ushqimit, dhe ka këto organe drejtuese, mbikëqyrëse dhe këshillëdhënëse si:

Organ Drejtues: Kryeshefi Ekzekutiv,

Organ Mbikëqyrës: Bordi Drejtues, dhe

Organ Këshillëdhënës: Këshilli Shkencor i Agjencisë.

Me rregullore të brendshme të AUV-së veprojnë këto drejtori:

- Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve;
- Drejtoria e Shëndetit Publik;
- Drejtoria e Inspektoratit AUV (Inspektorati Veterinar, Fitosanitar dhe Sanitar);
- Drejtoria e Administratës;
- LVUK (Laboratori).

4.4 Agjencitë dhe organet tjera të Republikës së Kosovës të përfshira në MIK

Në Menaxhimin e IntegrUAR të Kufirit, përfshihen edhe agjencitë dhe organet tjera që nuk janë drejtpërdrejtë të përfshira në punën praktike kufitare, por në një masë të caktuar varen ose ndërveprojnë me agjencitë kryesore të MIK-ut.

Agjencitë apo organet tjera të lartpërmendura janë, por nuk kufizohen në:

Departamenti i Transportit Rrugor – **MI**;

Departamenti i Inspektoratit – **MI**;

Departamenti i Transportit të Aviacionit Civil, Hekurudhor dhe Detar- **MI**;

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale - **MSH**;

Agjencia Kadastrale e Kosovës- **MMPH**;

Departamenti i Teknologjisë Informative – **MAP**;

Agjencia Pyjore e Kosovës – **MBPZHR**;

Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore – **MMPH**;

Agjenci dhe shërbime tjera.

Po ashtu, në MIK përfshihen edhe ZKM ,MD, MPJ, MF, MTI, MAPL, MIE, si dhe në raste të situatave emergjente MFSK si dhe akterët tjerë jo shtetëror të cilët operojnë në PKK.

Bashkëpunimi me akterët tjerë

Përveç autoriteteve dhe agjencive kryesore të menaxhimit kufitar janë edhe akterë tjerë shtesë qeveritarë dhe të sektorit privat, aktivitetet dhe interesat e të cilëve duhet të merren parasysh, dhe të cilët duhet të jenë të përfshirë në bashkërendim (koordinim) / bashkëpunim të strukturave të MIK-ut, pavarësisht a do të jetë ai bashkëpunim ad hoc ose në baza më të përhershme. Bashkëpunimi dhe komunikimi me të dy grupet e akterëve (palët e interesit) duhet të rregullohet me legjislacion apo përmes marrëveshjeve dhe procedurave dypalëshe/ shumëpalëshe.

Ky bashkëpunim ndahet në:

• Bashkëpunim me akterët shtetëror;

Përderisa agjencia përgjegjëse për kontrollin e personave, siç është policia kufitare, është përgjegjëse për kontrollimet në PKK-ve dhe mbikëqyrjen e vijës kufitare dhe zonës kufitare, policia dhe autoritetet e imigracionit janë përgjegjëse për kontrollin në brendësi. Kjo mund të çojë në përzierjen e përgjegjësive lidhur me luftën kundër krimit ndër-kufitar, ku të dyja agjencitë janë të përfshira. Përveç ndarjes së qartë të përgjegjësive për raste të tilla dhe

procedurave të sakta për bashkëpunim, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitetet tjera mbështetëse janë të nevojshme. Të dy autoritetet duhet të bien dakord për cilat të dhëna ata duhet të kenë qasje të përbashkët, të tilla si të dhënat mbi personat të cilëve i është refuzuar hyrja. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çështjes së mbrojtjes së të dhënave, të drejtat dhe detyrimet e atyre zyrtarëve të cilët kanë qenë të autorizuar për të hyrë në ato të dhëna.

Përderisa një nga detyrat kryesore të menaxhimit të kufijve është parandalimi i krimit ndërkuftar, bashkëpunimi i ngushtë me zyrën e prokurorit të shtetit (Ministria e Drejtësisë) është i nevojshëm. Në lidhje me ekstradimin, të dy agjencitë duhet të bashkëpunojnë ngushtë. Për udhëzime të shkruara dhe shkëmbim ad hoc të informacionit mbi çështjet e lidhura me kthimin dhe për çështje të ndërlidhura duhet të arrihet pajtueshmëri reciproke.

Policia Kufitare duhet të kontrolloj dhe mund të pranojë, refuzojë ose të revokojë vizat dhe duhet, në qoftë se PKK nuk është e lidhur direkt, të krijojë një mekanizëm konsultimi me departamentin konsullor të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Edhe nëse në PKK dhe në konsullata përdoren sisteme të ndryshme të TI-së, policia kufitare duhet të ketë qasje në regjistrin e vizave në mënyrë që ata mund të kontrollojnë në kufi vizat e lëshuara.

Një marrëveshje ndërmjet agjencisë për menaxhimin e kufirit përgjegjëse për kontrollimin e personave dhe zyrës kombëtare përgjegjëse për lëshimin dhe kontrollin e lejeve të punës dhe (p.sh. zyra kombëtare e punës, Ministria e Punës), mund të konsiderohet, duke paraparë kontrole të përbashkëta dhe shkëmbim të informacionit në lidhje me të huajt që qëndrojnë ose punojnë në vend ilegalisht dhe njerëzit që punësojnë të huaj pa leje apo organizojnë qëndrim të paligjshëm.

Memorandumet e Mirëkuptimit duhet të nënshkruhen me autoritetet e aeroportit ose Ministrinë e Infrastrukturës, përderisa shkëmbimi i informacionit dhe bashkërendimi lidhur me orët e punës dhe përdorimin e infrastrukturës janë të nevojshme.

• **Bashkëpunimi me akterët jo-shtetëror;**

Bashkëpunimi i agjencive kufitare me akterët jo-shtetërorë përfshin operatorët e linjave ajrore, dhe operatorët e tjerë, transportuesit a ngarkesave ajrore dhe të transportit, kompanitë hekurudhore, kompanitë apo shërbimet postare, shpeditoret dhe importuesit në vendet e origjinës dhe destinacionit të mallrave. Me qëllim të lehtësimit të tregtisë, procedurat përkatëse duhet të thjeshtëzohen aq sa të jetë e mundur, përderisa ende mbahet kontrolli adekuat. Përditësimet e procedurave duhet të komunikohen në mënyrë rutinore për të gjitha kompanitë tregtare. Koha e pritjes në kufi ndikon në biznes, kështu që kur një PKK - për shkak të infrastrukturës joadekuate ose procedurave të gjata - ka në mënyrë të konsiderueshme kohë më të gjatë të pritjeve, kjo mund të motivojë kompanitë e transportit të shikojnë për rrugë alternative, e cila përfundimisht mund të çojë në nënvlerësimin e PKK-së dhe humbjen e vendeve të punës. Përderisa agjencitë shtetërore të kufirit kanë nevojë për informacion mbi lëvizjet ndërkuftare lidhur me personat dhe mallrat (psh. orari, listat e pasagjerëve, informacion mbi ngarkesat), akterët jo-shtetëror kërkojnë informacion mbi procedurat dhe kërkesat për kalimin e kufirit, duke

përfshirë orarin e punës, udhëzues mbi tarifën, rregullat dhe procedurat për tranzit, importin dhe eksportin, dokumentacionin që duhet siguruar dhe tarifën që do të paguhet. Ky informacion mund të shpërndahet përmes njoftimeve publike, publikimeve në internet, gazeta, fletushka apo si një doracak. Informacioni urgjent duhet të shfaqet në tabelat e shpalljeve publike. Për të lehtësuar komunikimin, strukturat e përshtatshme (p.sh. rrjetet lokale, pikat e informacionit / tavolinat informative në zyrat e doganës) duhet të krijohen ku operatorët dhe personat tjerë mund të marrin informacionin e duhur. Përveç kësaj, standardet për shërbimet e ofruara për tregtarët dhe publikun, por edhe për procedurat e ankesave, duhet të jenë të rregulluara/publikuara.

Transportuesit / operatorët që transportojnë pasagjerë dhe mallra përmes ajrit apo tokës (hekurudhor ose rrugor) kanë qasje në të dhëna dhe informacioni i cili është me rëndësi për punën operacionale të agjencive kufitare. Kjo përfshin kohën e arritjes, listën e ngarkesës, listën e pasagjerëve dhe ekuipazhit nga transportuesit, të cilat duhet të jenë të përpiluara dhe të shkëmbyera paraprakisht. Transportuesve në anën tjetër ju duhet qasje në informata të hollësishme mbi procedurat e legjislacionit përkatës dhe tarifën apo detyrimet për t'u paguar, kërkesat për viza, orët e hapjes së PKK dhe orarit të punës të agjencive kufitare përkatëse. Nëse ky informacion është shpërndarë përmes broshurave, posterëve, ose nëpërmjet një web faqeje është çështje dytësore, për atë kohë sa informacioni është i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm për grupin e synuar. Në raste të caktuara Dogana mund të lehtësojë/përshtepojë lëvizjen e transportuesve të besuar, që do të thotë se ndërmarrjet e veçanta mund të marrin trajtim preferencial me kusht që ata i përcjellin paraprakisht të gjitha informatat në lidhje me operacionet e tyre dhe kanë mbajtur një marrëdhënie pozitive dhe të saktë gjatë punës së tyre për një periudhë të caktuar kohe. Megjithatë, edhe këta transportues duhet të mbikëqyren dhe vlerësohen në baza të zgjedhjes së rastit. Transportuesit mund të humbasin privilegjet e tyre dhe të përjashtohen nga procedura e operatorëve të autorizuar ekonomik (OAE) për tre vjet në rast të shkeljeve dhe gjithashtu mund të jenë subjekt i sanksioneve të përgjegjësisë së transportuesve, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar. Kompanitë hekurudhore mund të ofrojnë ambiente dhe hapësirat e tyre për zyrtarët e agjencive të menaxhimit kufitar në stacionet e trenave në vendet fqinje, pasi që këto kompani përfitojnë nga koha e kursyer gjatë kontrollimeve kufitare në tren (kur treni është në lëvizje, në vend se të ndaljet në kufi).

•Bashkëpunimi me publikun

Informacione lehtësisht të kuptueshme, të arritshme dhe të përditësuara mbi çështjet relevante për kalimin e kufirit shtetëror duhet të ofrohen për publikun, duke përfshirë standardet, statistikën mbi kalimet kufitare, rregulloret dhe procedurat përkatëse, si dhe informacion mbi kundërvajtjet. Kjo mund të marrë formën e tabelave të shpalljeve publike në PKK apo broshurave, posterëve dhe web faqeve. Aty ku mund të realizohet, komunikimi me publikun e gjerë duhet të inkurajohet me ofrimin e numrave të telefonave pa pagesë (thirrje falas) dhe metodave të thjeshtuara të kontaktit përmes internetit. Kjo gjithashtu rrit shanset e pranimit të informatave inteligjente nga publiku, i cili mund të kanalizohet në njësitë e brendshme të analizës së rrezikut. Një portal interneti i përbashkët i disa agjencive të menaxhimit kufitar mund të merret në konsideratë për të informuar publikun në lidhje me orët dhe orarin e punës së PKK-ve, rregulloret e vizave, kërkesat e sigurimit të makinave, certifikata e vaksinimit për kafshët dhe informacione të tjera përkatëse, duke shpjeguar detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha agjencive të pranishme.

KAPITULLI

IV

5. AUTORITETI BASHKËRENDUES

Më qëllim të bashkërendimit dhe bashkëpunimit për MIK, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërtuar strukturën bashkërenduese me fuqi vendimmarrëse politike që përfshinë përfaqësues nga ministritë drejtpërdrejtë të përfshira në MIK. Detyra kryesore e organit mbikëqyrës dhe vendimmarrës është që të siguroj angazhimin politik për Strategjinë Kombëtare të MIK-ut dhe mbikëqyrë zbatimin e saj.

Po ashtu, në kuadër të strukturës bashkërenduese është funksional edhe mekanizmi bashkërendues për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar.

5.1 Detyrat e organit mbikëqyrës dhe vendimmarrës:

- Identifikimi i prioriteteve në fushën e bashkëpunimit për MIK;
- Sigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare – nga Buxheti i Kosovës dhe fondet e jashtme për të jetësuar reformat në kuadër të MIK-ut;
- Miratimi i dokumenteve zyrtare që lidhen me MIK ose inicimi i procedurave ligjore për miratim (në varësi të sistemit ligjor kombëtar dhe nivelit të pjesëmarrësve në organin mbikëqyrës);
- Monitorimi i vënies në jetë të Strategjisë së MIK-ut dhe Planit të Veprimit dhe azhurnimi i rregullt i Strategjisë në harmoni me prioritetet nacionale;
- Bashkërendimi i Strategjisë me vendet fqinje, si dhe mbikëqyrja e vënies në jetë e veprimtarive që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e bashkërendimit dhe bashkëpunimit të MIK-ut me organet e tjera bashkërenduese të nivelit të lartë në rajon;
- Sinkronizimi i punës së të gjitha organeve të administratës shtetërore të përfshira në menaxhimin e kufirit si dhe me persona juridik të përfshirë në trafikun kufitar në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
- Mbikëqyrja e punës së Bordit Ekzekutiv;
- Bashkëpunimi me dhe afrimi i udhëzimeve për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organeve rajonale dhe lokale në çështjet që lidhen me MIK-un dhe afrimi i sugjerimeve për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme.

Në kuadër të strukturës bashkërenduese funksionon Bordi Ekzekutiv për MIK dhe përbëhet nga:

- Koordinatori Nacional për MIK;
- Drejtori i Departamentit për Kufij;
- Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës;
- Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës;
- Sekretari i Përgjithshëm i MIE; dhe
- Përfaqësues nga institucionet tjera sipas nevojës.

Bordi Ekzekutiv për MIK është përgjegjës dhe merr vendime për çështjet që kanë të bëjnë me:

- Inicimin dhe bashkërendimin e reformave të nevojshme për të siguruar që të ekzistojnë kushtet administrative, institucionale dhe legjislative për zbatimin e MIK-ut;

- Vënien në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë së MIK-ut, sipas shtyllave të MIK-ut;
- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet autoriteteve;
- Përditësimin e rregullt të Strategjisë së MIK dhe Planit të Veprimit;
- Bashkëpunimin me të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet tjera lokale dhe rajonale ndërkombëtare për çështje që lidhen me MIK;
- Sigurimin e ndihmës për organet e administratës shtetërore në çështjet e MIK, duke përfshirë bashkërendimin e veprimtarive apo projekteve të veçanta;
- Rishikimin e Strategjisë së MIK dhe Planit të Veprimit;
- Krijimin dhe bashkërendimin e nën-grupeve të punës për zbatimin e Planit të Veprimit;
- Afrimin e sugjerimeve për zgjidhjen e çështjeve të kontestuara midis autoriteteve relevante të përfshira në MIK dhe personave juridik të përfshirë në trafikun kufitar;
- Detyra të tjera, siç kërkohet nga organi drejtues politik dhe vendimmarrës.

5.2 Detyrat e grupit punues për zbatim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për MIK, janë:

- Hartimi i një plani të detajuar të punës dhe përcaktimi i afatit kohor për zhvillimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit;
- Kryerja e një vlerësimi të hollësishëm për mangësitë dhe nevojat lidhur me situatën e menaxhimit të kufirit kombëtar;
- Hartimi i strategjisë, si dhe planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë;
- Zbatimi i pjesëve të planit të veprimit lidhur me bashkëpunimin ndërmjet agjencive,
- Shqyrtimi periodik dhe azhurnimi i Strategjisë së MIK dhe Planit të Veprimit;
- Afrimi/sigurimi i rekomandimeve për përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet agjencive;
- Sigurimi i ndihmës për organet e administratës shtetërore në çështjet e bashkëpunimit për MIK, duke u përfshirë në bashkërendimin e aktiviteteve / projekteve individuale;
- Krijimi dhe bashkërendimi i nën-grupeve punuese të ekspertëve kur është e nevojshme;
- Raportimi i rregullt për organin vendimmarrës, duke përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e rezultateve, bazuar në termat e referencës për frekuencën dhe afatin e raportimit;
- Detyra të tjera që kërkohen nga Bordi Ekzekutiv.

5.3 Detyrat e Sekretariatit MIK (Zyra e Koordinatorit Nacional për MIK):

- E drejtë dhe detyrë themelore e Sekretariatit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera për zbatimin e Strategjive Nationale nën përgjegjësinë e MPB-së;
- Sekretariati bën analizimin dhe vlerësimin e atyre informatave;
- Sekretariati bën përgatitjen e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional. Sekretariati nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Nacional bën monitorimin dhe vlerësimin e kryerjes së aktiviteteve që dalin nga plani i veprimit;
- Propozon ndryshime dhe përmirësime në sistemet dhe mekanizmat e Strategjisë Nationale përmes Koordinatorit Nacional;
- Sekretariati rekomandon dhe këshillon Koordinatorin Nacional për hapat që duhet të ndërmerren në drejtim të zbatimit të Strategjisë për MIK;
- Në emër të Zyrës së Koordinatorit, Sekretariati prezanton zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Nationale për MIK;
- Nxit rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore, të përfshira në Strategjitë Nationale duke bashkëpunuar me institucione tjera dhe shoqërinë civile;
- Sekretariati administron bazën e të dhënave të MIK-ut dhe i raporton Koordinatorit Nacional;
- Monitoron veprimtarinë e institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë për MIK-un.

5.4 Mjetet buxhetore

Për zbatimin e Strategjisë së MIK dhe Planit të Veprimit një prej faktorëve kyç është sigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare apo fondeve të qëndrueshme.

Aktualisht të gjitha agjencitë e përfshira në MIK financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe përballen me probleme financiare për shkak të buxhetit të kufizuar në kuadër të ministrive përkatëse. Buxheti i veçantë për MIK mungon.

Pasi MIK të jetë vënë në zbatim, disa prej shpenzimeve do të rriten dhe disa prej tyre do të reduktohen. Rritja e shpenzimit do të jetë kryesisht një pasojë e angazhimeve shtesë dhe detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia MIK. Nga ana tjetër disa prej shpenzimeve do të shkurtohen (përdorimi i përbashkët i pajisjeve, grupet e përbashkëta, infrastruktura e përbashkët, etj) dhe ato mund të rishpërndahen për qëllime të tjera ose aty ku janë vënë re mangësitë.

Pa angazhime buxhetore transparente dhe të përcaktuara qartë do të ishte e vështirë jo vetëm të vihej në zbatim Strategjia MIK dhe Planit të Veprimit, por edhe garantimi i punës profesionale të gjitha agjencive.

Mënyra më e volitshme do të ishte një buxhet për MIK i ndarë nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe shpërndarje për çdo ministri të përfshirë në MIK. Buxheti për MIK duhet të ndahet nga buxheti kryesor i cili i caktohet çdo ministrie rregullisht dhe në një periudhë të rregullt kohore. Përveç kësaj, shpenzimi i buxhetit MIK duhet të bashkërendohet në marrëveshje me të gjitha agjencitë.

KAPITULLI

V

6. BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI I TRI SHTYLLAVE TË MIK

Ky kapitull është thelbi i strategjisë së përshkruar me objektivat strategjike të saj.

Kapitulli është i ndarë në nënkapituj sipas tri shtyllave të MIK: bashkëpunimi midis shërbimeve, bashkëpunimi midis agjencive dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Secili prej nënkapitujve mbulon fushat në vijim të bashkëpunimit:

- Korniza ligjore dhe rregullatore, përshkruan bazën e nevojshme ligjore për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit;
- Organizimi dhe menaxhimi (kuadri institucional) siguron rregullimin organizativ të rekomanduar për zbatimin e MIK-ut;
- Procedurat për bashkëpunim;
- Burimet njerëzore dhe trajnimi, merret me çështet e rekrutimit dhe edukimit/ trajnimit në kuadër të bashkërendimit dhe bashkëpunimit;
- Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit, jep udhëzime se si më së miri të krijohen flukse të standardizuara dhe efikase të shkëmbimit të informacionit;
- Infrastruktura dhe pajisjet, plotëson çdo kapitull duke rekomanduar se si pajisjet dhe objektet mund të mbështesin bashkëpunimin dhe bashkërendimin në të gjitha nivelet.

Për secilën fushë të bashkëpunimit bëhet një përshkrim i shkurtër i gjendjes ekzistuese, vlerësimi i mangësive aktuale dhe objektivat strategjike të secilit parametër.

Hapat specifike që do të ndërmerren drejt vënies në jetë të qëllimeve të strategjisë do të përshkruhen në planin e veprimit.

6.1 BASHKËPUNIMI BRENDA AGJENCISË

6.1.1 POLICIA KUFITARE

Bashkëpunimi brenda PK-së në bazë të parametrave që paraqiten në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit është në nivel të mirë, por ende ka vend për përmirësim. Ky bashkëpunim ushtrohet në dy nivele, në nivelin lokal dhe qendror. Në vijim do t'i elaborojmë të gjitha parametrat e paraqitura në Strategjinë e MIK-ut.

6.1.1.1 Korniza ligjore

PK-ja detyrat dhe përgjegjësitë e saj i ushtron në mbështetje të Kushtetutës së vendit, Ligjit për Policinë, Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligjit për Bashkëpunim ndërmjet agjencive të përfshira në MIK, Ligjit për të Huajt, Ligjit për Azilin si dhe Rregullores së Brendshme të Policisë dhe akteve tjera nënligjore që rregullojnë fushëveprimin e PK-së në punën kufitare.

Të gjitha ligjet që rregullojnë fushën e Policisë Kufitare janë në fuqi dhe janë të harmonizuara me legjislacionin e BE-së.

Objektiv i PK-së është harmonizimi i Rregullores së brendshme të Policisë së Kosovës, me legjislacionin në fuqi ku është bërë përshkrimi i saktë i detyrave për PK-në, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.

6.1.1.2 Organizimi dhe menaxhimi

Struktura aktuale organizative e Policisë Kufitare garanton një menaxhim efikas të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike. Kjo strukturë është e harmonizuar me Ligjin e ri të Policisë si dhe me strukturën e përgjithshme të PK-së e cila garanton një funksionalitet normal për t'i përmbushur nevojat dhe detyrat e përditshme.

Një ndër objektivat e PK-së është funksionalizimi-implementimi i strukturës së re të PK-së. Objektivi tjetër e PK-së është marrja graduale e përgjegjësisë nga KFOR-i për kontrollimin e vijës së gjelbër dhe të kaltër në kufirin me Republikën e Serbisë.

6.1.1.3 Procedurat

Procedurat që kryhen në kufi bazohen në ligjet në fuqi dhe janë në harmoni me standardet e BE-së. Përgjegjësitë e personelit policor janë të qarta në raport me përgjegjësitë e agjencive tjera. Të gjitha detyrat që i kryen policia kufitare janë të rregulluara me ligje, akte nënligjore si dhe PSO.

Objektiv i PK-së është bashkëpunimi i ngushtë me departamentet tjera në Policinë e Kosovës, me qëllim të kontrollimit të vijës kufitare, kur paraqitet nevoja edhe në brendësinë e territorit të vendit dhe kjo bëhet duke u bazuar në analizën së rrezikut.

6.1.1.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

PK ka mungesë të burimeve njerëzore dhe ekziston nevoja për një rritje të ndjeshme të burimeve njerëzore në kuadër të PK-së.

Zyrtarët e PK-së marrin pjesë në disa trajnime të cilat mbahen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), si dhe trajnime të brendshme në shërbim. Trajnimet e organizuara të cilat i ndjekin zyrtarët e PK-së i plotësojnë nevojat e shërbimit ku shpeshherë organizohen trajnime, seminare, punëtori dhe vizita të ndryshme studimore jashtë vendit, të mbështetura dhe financuara nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Është hartuar dhe aprovuar manuali i veçantë për trajnimin e zyrtarëve policorë të policisë kufitare i cili ofron trajnime të specializuara dhe të përgjithshme për të gjithë stafin me qëllim të arritjes të nivelit të duhur profesional.

Trajnimi është një element i vazhdueshëm për stafin gjatë tërë karrierës së tyre (trajnim rifreskues, specializues dhe për zhvillim të aftësive/ informacioneve të reja/ që bazohet në programe dhe manuale të azhurnuara rregullisht. Kurse të specializuara dhe të avancuara duhet të zhvillohen për:

- Kontrollimet kufitare
- Inteligjencës kriminale
- Analizat e rrezikut dhe profilizimin
- Zbulimin e automjeteve të vjedhura
- Zbulimin e dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara
- Zbulimin e njerëzve të fshehur brenda automjeteve
- Gjendja e përdorimit të pajisjeve të artit
- Kujdestarët e qenve
- Të drejtat e njeriut dhe që kanë të bëjnë me azilkërkuesit

Koncepti i MIK-ut duhet të jetë pjesë integrale e trajnimeve. Për të forcuar efikasitetin e përgjithshëm, me qëllim të parandalimit të aktiviteteve të paligjshme dhe kriminale, manuali i trajnimeve është i mbështetur në:

Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligjin për Bashkëpunim në mes të Agjencive të përfshira në MIK, Ligjin e Policisë, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Azilin, Ligjin për të Huajt, si dhe akteve tjera nënligjore që rregullojnë fushëveprimin për luftimin e kontrabandës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, zbulimin e dokumenteve të falsifikuara, parandalimin dhe zbulimin e automjeteve të vjedhura, luftimin e kontrabandës me narkotikë, armëve, eksplozivëve dhe substancave tjera të rrezikshme.

Për të arritur këtë duhet të respektohet edhe menaxhimi me trajnime sipas kritereve që përcakton policia kufitare, dhe të respektohet menaxhimi i burimeve njerëzore në mënyrë të pavarur nga PK-ja sipas marrëveshjes së Shengenit.

6.1.1.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Qëllimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit është rregullimi dhe standardizimi i një fluksi eficient dhe i shpejtë i informacionit dhe dokumentimi efektiv.

Stafi operacional duhet të ketë informata relevante dhe të azhurnuara për përmbushjen e detyrave të tyre, me qëllim të përgjigjes adekuate ndaj kërcënimeve, rreziqeve dhe emergjencave. Një njësi e nivelit qendror, në anën tjetër, ka nevojë për statistika dhe të dhëna, si dhe informacion në lidhje me aktivitetet e njësive të tjera, pasi kjo formon bazën për buxhet, resurse, udhëzime, planifikim dhe formulim të strategjive dhe ndihmon në monitorimin e punës së njësive rajonale dhe lokale.

Për të siguruar një komunikim efikas, komunikimi vertikal dhe horizontal duhet të jetë i qëndrueshëm dhe pa ndërhyrje nga jashtë. Në të gjitha PKK është instaluar linja e telefonisë fikse si dhe intraneti. Për të mundësuar bashkëpunim më të ngushtë dhe efikasitetit më të lartë operacional në terren mes PK-së dhe shtyllave tjera policore, funksionon sistemi i komunikimit për shkëmbimin e informatave SIPK në të gjitha PKK-të.

Sistemi i shkëmbimit të informacionit duhet të përshkruhet në udhëzimet operative ose në manual, i cili gjithashtu duhet të përfshij forma të standardizuara dhe mostra për raportimin e të dhënave statistikore ose informacione. Duke pasur një sistem të harmonizuar të mbledhjes së informatave gjithashtu lehtëson shkëmbimin e të dhënave dhe bashkëpunimin me shërbimet tjera.

Policia kufitare tani është duke e përdorur sistemin BMS për regjistrim të hyrje -daljeve të udhëtarëve dhe automjeteve në të gjitha pikat e kalimit kufitar, i cili është funksional, ku po vazhdojnë të paraqiten probleme teknike të ndryshme si (rënia nga sistemi, ngadalësimi i regjistrimit dhe leximit të dokumenteve, etj). Ky sistem është donacion i BE-së dhe pas përfundimit të fazës testuse të tij është marrë në menaxhim nga Policia e Kosovës.

Policia Kufitare, përveç sistemit BMS shfrytëzon edhe bazën e të dhënave Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK). Sistemi i TI-së e mundëson pranimin dhe shpërndarjen e informatave për të gjitha aktivitetet në kuadër të Policisë.

Objektiv i Policisë Kufitare është funksionalizimi i plotë dhe evitimi i problemeve të identifikuara, si dhe zhvillimi i sistemit sipas standardeve të BE-së.

6.1.1.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Nga 17 PKK-të aktuale (tri nga këto janë të përkohshme) janë edhe dy PKK të trafikut hekurudhor Hani i Elezit dhe Leshaku, të cilat janë funksionale.

Kushtet rreth infrastrukturës rrugore, objekteve dhe pajisjeve janë përmirësuar dukshëm. Në PKK-të përgjatë kufirit me Republikën e Serbisë dhe me Malin e Zi, ende kanë mbetur në shfytëzim kontejnerët.

Janë bërë plane reale të investimeve për t'u siguruar që infrastruktura dhe pajisjet të jenë konform standardeve të BE-së për të gjitha nivelet.

Me qëllim që të kemi shërbime sa më efikase dhe të rritjes së sigurisë në përgjithësi, zyrtarët policor duhet në vazhdimësi të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate për përdorimin e pajisjeve që i posedojnë.

Policia Kufitare është në themelim e sipër të njësitit K-9 me infrastrukturën përcjellëse. Ky projekt do të realizohet në tri faza. Faza e parë Qershor 2012-2013, faza e dytë Qershor 2013-2014 dhe faza e tretë Dhjetor 2014.

Bazuar në Konkluzionet e Dakorduara për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) dhe lëvizjen e lirë të arritur me ndërmjetësimin ndërkombëtar në Bruksel, në kufirin me Republikën e Serbisë parashihet ndërtimi i gjashtë (6) objekteve të përbashkëta me infrastrukturë përcjellëse në Pikat e Kalimit Kufitar, si projekt i BE-së.

Me Republikën e Maqedonisë është në zbatim e sipër ndërtimi i PKK-së së përbashkët në Stançiq-Bellanovc- po ashtu projekt i financuar nga BE.

6.1.2 DOGANA E KOSOVËS

Detyrat kryesore të Doganës së Kosovës, janë të përcaktuara qartë në Planin Strategjik 2013-2015 dhe dokumentet tjera strategjike, ku mision primar është sigurimi i qarkullimit të shpejtë të mallrave të ligjshme dhe udhëtarëve dhe siguria e zonave kufitare, me mbledhjen efikase të hyrave, në përputhje me rregullat, me të vetmin qëllim zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Kosovës.

Dogana e Kosovës, në punën e saj ndjek standardet e Bashkimit Evropian, Organizatës Botërore të Doganave dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë, me qëllim të veprimit në pajtim me praktikat e mira. DK, nëpërmjet përmbushjes së detyrave brenda kompetencës së saj, do të lehtësojë punën e ndërmarrjeve vendore dhe të huaja të biznesit që marrin pjesë në procedurat doganore, nga ana tjetër do të bëjë zbatimin e masave që ndërlidhen me mbrojtjen e kufirit shtetëror, mbrojtjen e buxhetit, ekonomisë, tregtisë, trashëgimisë kulturore, bimëve të mbrojtura dhe specieve të kafshëve, shëndetin e qytetarëve dhe ruajtjen e mjedisit.

Dogana e Kosovës, në kuadër të respektimit të kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare dhe me qëllim të sigurisë së territorit doganor dhe zhvillimit më të shpejtë të ekonomisë së Republikës së Kosovës, zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmave për lehtësimin e tregtisë të përqendruara në qarkullimin e shpejtë të mallrave të ligjshme, reduktimit të dokumentacionit dhe krijimin e një biznesi pa letra “paperless”, uljen e shpenzimeve për kryerjen e procedurave doganore, si dhe thjeshtësimin e deklarimit të mallrave, do të zbatojë dhe plotësojë në mënyrë aktive këto kërkesa dhe standarde ndërkombëtare.

6.1.2.1 Korniza ligjore

Legjislacioni doganor bazë në Republikën e Kosovës përbëhet nga: Kodi Doganor dhe Akcizave, Udhëzimi Administrativ për implementimin e tij, vendimet dhe aktet tjera normative të ministrit të Financave dhe drejtorit të Përgjithshëm të Doganës.

Kodi Doganor dhe Akcizave në fuqi është në përputhje me kërkesat e BE-së, megjithatë, më shumë punë po bëhet për ta përditësuar atë që të jetë në përputhje me legjislacionin e ri doganor të BE-së.

Sistematizimi dhe përshkrimi i qartë i detyrave të zyrtarëve doganorë është përshkruar në Udhëzimin e brendshëm administrativ mbi organizimin e sistematizimin e personelit.

Dogana e Kosovës pavarësisht një bashkëpunimi ekzistues mirë të koordinuar dhe funksional, synon të përmirësojë edhe më tutje bashkëpunimin brenda shërbimit në nivelin qendror dhe atë lokal si dhe përbrenda vetë njësisive organizative.

Për këtë qëllim janë hartuar një numër i akteve normative për të normuar e rregulluar format e bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe përdorimit të pajisjeve dhe

infrastrukturës. Të gjitha këto akte rregullojnë marrëdhëniet dhe procedurat për bashkëpunimin mes niveleve dhe njësive organizative të doganës.

Gjatë aplikimit është vërejtur nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të akteve ekzistuese si dhe nxjerrja e akteve tjera normative me qëllim të zbatimit të praktikave të mira të BE-së në këtë fushë, si dhe të përmbushen objektivat e dala nga EU-Blueprint.

Legjislacioni doganor duhet të rishikohet me qëllim që të kemi një legjislacion modern dhe të thjeshtuar me kosto të reduktuara për bizneset dhe që shton sigurinë ligjore për qytetarët.

6.1.2.2 Organizimi dhe menaxhimi

Janë marrë dhe në vazhdimësi janë duke u marrë masa për përmirësimin e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve dhe atë përmes decentralizimit të sistemit të vendimmarrjes. Për këtë arsye është e rëndësishme që të sigurohen burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore duke u bazuar në plane adekuate menaxhuese. Është vendosur kontroll efikas dhe i pavarur me qëllim të shfrytëzimit të duhur të burimeve të mësipërme lidhur me mbikëqyrjen e punës së oficerëve doganor në të gjitha nivelet. Bëhen planifikime strategjike, alokim i personelit dhe burimeve teknike, bazuar në një analizë të vazhdueshme të mjedisit dhe kërcënimeve. Bëhen planifikime të aktiviteteve për menaxhimin e kufirit të udhëhequra nga inteligjenca.

Dogana e Kosovës ka ngritur një strukturë organizative që mundëson zbatimin efektiv dhe efikas të detyrave të saj, si dhe ofron bashkëpunim dhe komunikimin efikas brenda agjencisë (shërbimit).

Struktura e doganës caktohet çdo vit nga drejtori i Përgjithshëm sipas miratimit paraprak të ministrit të Financave dhe procedurës së dhënë në udhëzimet e brendshme të doganës. Struktura e DK organizohet në dy nivele:

- Nivel Qendror - Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, dhe
- Nivel Lokal – Zyrat Doganore dhe PKK-të.

Sipas strukturës organizative të aprovuar në vitin 2013 nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganës, DK organizohet në katër drejtori, si vijon:

- Drejtoria e Operimit të Hyrave;
- Drejtoria e Zbatimit të Ligjit;
- Drejtoria Ligjore;
- Drejtoria e Financave dhe Sistemeve.

Për të siguruar përdorim efikas të burimeve të sipërpërmendura si dhe për të rishikuar punën e personelit të doganave, në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës ka strukturë të posaçme që kryen auditim të brendshëm, të efektshëm dhe të pavarur duke përdorur një sistem cilësor menaxhimi. Auditimi i brendshëm, **inspektimi i brendshëm dhe standardet profesionale janë strukturë në vartësi të Drejtorit të Përgjithshëm.**

Objektiv i DK-së është organizimi dhe menaxhimi i një strukture organizative që i përgjigjet gjendjes aktuale në vendin tonë, me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të personelit duke iu përgjigjur kërkesave ligjore të komunitetit të biznesit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe duke arritur objektivat e mëposhtme:

- Përpilimi i planeve për ngritjen profesionale të personelit ekzistues dhe plotësimi me personel sipas strukturës organizative;
- Zhvillimi i një sistemi efektiv menaxhues të burimeve njerëzore i cili mbështetet në arritjen e objektivave të DK-së, që bazohet dhe përputhet me legjislacionin në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare, e që në veçanti merr parasysh faktin se njerëzit janë **burimi më i vlefshëm i organizatës;**
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit menaxhues dhe organizativ i cili eliminon apo i minimizon mundësitë për sjellje të këqija dhe korrupsion;
- Të punohet në vazhdimësi në ngritjen e kapaciteteve me qëllim që strukturat të jenë më fleksibile, të afta të lehtësojnë tregtinë e lirë, plotësisht operacionale dhe të afta të parandalojnë aktivitetet e kundërligjshme.

Pagat e personelit doganor financohen nga buxheti i Kosovës. Për çdo vit sipas legjislacionit në fuqi për administratën shtetërore miratohen fonde investive. Aktualisht DK ka përgatitur disa projekte lidhur me infrastrukturën ekzistuese dhe është në pritje të financimeve si nga buxheti shtetëror dhe nga donatorët e mundshëm si dhe realizmit të këtyre projekte.

6.1.2.3 Procedurat

Kompetencat, autorizimet dhe procedurat e DK-së përcaktohen sipas Kodit Doganor dhe Akcizave dhe dispozitave zbatuese të tij. Megjithatë, për të rritur efikasitetin dhe standardizimin e vënies së tyre në zbatim DK ka sjellë urdhëresa, qarkore, procedura standarde të operimit dhe udhëzime tjera të Drejtorit të Përgjithshëm, që janë në dispozicion si referencë për të gjithë stafin gjatë gjithë kohës.

Me qëllim të sigurisë së territorin doganor dhe zhvillimit më të shpejtë të ekonomisë së Republikës së Kosovës, do të zhvillohen dhe zbatohen mekanizma për lehtësimin e tregtisë ku si pikësynim kanë qarkullimin e shpejtë të mallrave të ligjshme, reduktimin e dokumentacionit dhe

krijimin e bizneseve pa letra “paperless”, si dhe thjeshtëzimin e deklarimit të mallrave. Gjithashtu, Dogana e Kosovës, do të përqëndrojë përpjekjet e saj në zhvillimin e një sistemi të informacionit në mënyrë që të sigurojë mbështetjen elektronike për procedurën e thjeshtuar të deklarimit të mallrave në bazë të rregullave të kontabilitetit, përmes të cilës do të mundësohet monitorimi elektronik i procedurave të thjeshtuara, të përshpejtohet qarkullimi i mallrave, të zvogëlohen shpenzimet dhe të lehtësohen aktivitetet e terminaleve doganore. Përveç kësaj, planifikohet që në të ardhmen pas anëtarësimit të zbatohet ATA Karneti në Sistemin informativ të Doganës.

Procedurat doganore duhet të synojnë të arrijnë një ekuilibër të duhur mes nevojës për të lehtësuar rrjedhën e tregtisë dhe mbledhjen e të hyrave dhe mbrojtjen e qytetarëve. Ato duhet të mundësojnë lehtësimin e tregtisë legjitime, përderisa zbatojnë dhe mbështesin kërkesat e sigurisë.

Për të përmbushur këtë qëllim duhet të vazhdohet me avancimin e përdorimit të sistemit të analizës së riskut si bazë e vendimmarrjes në mënyrë që të zbatohen masat e kontrollit me përzgjedhje.

Standardizimi në zbatimin e procedurave doganore kërkon nxjerrjen e udhëzimeve të reja dhe akteve tjera sqaruese, përditësimin e PSO-ve në fuqi dhe nxjerrjen e PSO-ve të reja duke u bazuar në dokumentin EU Blueprint dhe në praktikatat e mira të BE-së.

Në këtë drejtim janë hartuar deri më tani dhe shpërndarë një numër i konsiderueshëm i udhëzimeve, PSO-ve dhe akteve tjera për Zyrat Doganore/PKK-të, ku edhe për të ardhmen planifikohet përditësimi i PSO-ve aktuale dhe përpilimi i PSO-ve të reja duke u bazuar në dokumentin EU Blueprint dhe në praktikatat e mira të BE-së.

Përveç udhëzimeve që gjejnë zbatim në rrethana normale, janë të nevojshme edhe planet e emergjencës për situatat e jashtëzakonshme të cilat vënë në rrezik jetën, sigurinë dhe shëndetin e njerëzve.

6.1.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

Dogana përkushtohet që detyrat dhe aktivitetet doganore t’ia besojë oficerëve të trajnuar profesionalisht. Hartimi i planeve të mira për resurset njerëzore të DK-së është në harmoni me dokumentin “EU Blueprint” dhe është përgjegjësi e Departamentit të Burimeve Njerëzore në kuadër të cilit departament janë të sistemuar Sektori i Personelit dhe Trajnimit. Për këtë qëllim, Dogana është duke zbatuar një strategji të menaxhimit të burimeve njerëzore që përcakton rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të Doganës së Kosovës, dhe përmes analizave të nevojave për trajnim (ANT) në nivel të drejtorive, departamenteve dhe sektorëve. Karakteri i aktivitetëve të zhvilluara është i shpërndarë në fushat trajnuese/zhvilluese: profesionale,

menaxheriale, teknike dhe ri-trajnuar/ri-certifikues. Për shkak të formave më komplekse të tregtisë ndërkombëtare, dogana do të zhvilloj në vazhdimësi programe të reja të trajnimit për oficerët doganorë, në mënyrë që të njihen plotësisht me legjislacionin doganor dhe aktet sekondare për zbatimin e tij, procedurat e punës dhe teknikat operative të sektorit privat.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit profesional nga fushat e mëposhtme:

- luftimit të kontrabandës (sidomos të narkotikëve, armëve, mallrave me përdorim të dyfishtë);
- inteligjencës;
- procedurave të transitit;
- përdorimit të pajisjeve speciale;
- analizave të rrezikut;
- pronës intelektuale;
- njohurisë së gjuhëve të huaja; dhe
- **aktiviteteve tjera.**

Gjithashtu, trajnimet rreth MIK-ut duhet të jenë një pjesë integrale e këtyre trajnimeve. Futja e një sistemi trajnimi të trajnuesve mund të merret në konsideratë, me të cilin më shumë trajnerë të brendshëm do të jenë në dispozicion që sa më shpejtë të përcjellin dijen (në formë kaskade) deri poshtë në nivel të terrenit.

Me qëllim të motivimit më të mirë lidhur me angazhimin e punonjësve të saj, dogana do të vazhdoj të funksionoj në një sistem transparent të vlerësimit, të promovimit të sistemit të shpërblimeve duke u bazuar në meritë dhe angazhim dhe po ashtu në monitorimin e performancës në mënyrë të paanshme.

6.1.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Dogana e Kosovës, zbaton një qasje të thjeshtë dhe disponueshmëri në informatat e fundit që janë të rëndësishme për miratimin e vendimeve të qëndrueshme dhe të njëtrajtshme me qëllim të implementimit të procedurave doganore, në harmoni me praktikën e EU Blueprint-it.

Oftohen udhëzime mbi menaxhimin e duhur të informacionit me kusht që secili doganier të njihet me përmbajtjen e informacionit të dhënë para fillimit të punës. Menaxhimi i mirë i informacionit është gjithashtu i rëndësishëm kur është fjala për sistemin e paralajmërimit të hershëm, sepse mundëson përgjigjen me kohë në një situatë të veçantë.

Arrihet dhe mirëmbahet komunikim në mes të zyrtarëve përmes mbajtjes së takimeve të rregullta dhe trajnimeve të përbashkëta për profile të ndryshme, përmes të cilave arrihet bashkëpunim më i mirë midis zyrtarëve dhe menaxhimit më të mirë të punëve.

Klientëve i është siguruar qasje më e lehtë në informata lidhur me procedurat doganore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Pavarësisht nga metoda e përdorur, (të punuar ose përmes aplikacionit

të TI, shkëmbimi i informacionit me anë të hard-kopjeve ose telefonit) mbrojtja e të dhënave duhet gjithmonë të jetë e garantuar. (*Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*).

Dogana është përfshirë në parandalimin e formave të ndryshme të krimit, ku janë përpiluar forma dhe mënyra të reja të bashkëpunimit me median. Dogana e Kosovës, si pjesë e sistemit shtetëror, synon ndërtimin, ruajtjen dhe rritjen e besimit të publikut karshi sistemit doganor si një organ i rëndësishëm, i orientuar drejt shërbimit profesional, i besueshëm dhe i paanshëm, i cili në mënyrë efikase dhe efektive kryen misionin e vet në mbrojtjen e shoqërisë dhe ekonomisë kundrejt kontrabandës dhe mashtrimit, kërcënimit ndaj mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe pasurive tjera.

Dogana e Kosovës, në përputhje me standardet e BE-së, do të nxis zhvillimin e informacionit dhe teknologjisë së komunikimit, gjegjësisht sistemeve që plotësisht mbështetsin funksionimin e doganës, përkrahin menaxhimin e rrezikut, lehtësojnë rrjedhën e tregtisë, mundësojnë aktivitetet doganore në nivelin më të lartë të efikasitetit dhe lejojnë ndërveprimin dhe ndërlidhjen me sistemet tjera. Si një qëllim afatgjatë parashihet zbatimi hap pas hapi i sistemit elektronik të ashtuquajtur "Paperless".

Menaxhmenti i doganës njih rëndësinë e madhe të investimit në teknologjinë e informacionit sepse zhvillimi i doganës duke vendosur objektiva të larta nuk është i mundur pa përkrahjen e TI-së.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij parametri luan edhe Teknologjia Informative. Dogana e Kosovës, ka filluar së aplikuari ASYCUDA World. Një ndër pikat kyçe të cilat Dogana e Kosovës i ka vendosur si kriter për selektimin e zgjidhjes së këtij sistemi të ri, është edhe përkrahje për MIK dhe Single Window. Janë përfunduar trajnimet fillestare të stafit dhe trajnimet do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Sistemet e TI-së në DK duhet të përditësohen në vazhdimësi dhe të:

- sigurojnë komunikimin në nivele të ndryshme të informacionit të transmetueshëm;
- funksionalizojnë dhe përditësojnë një bazë të dhënash qendrore;
- posedojnë një sistem efikas dhe me kohë të mbledhjes, përpunimit dhe shkëmbimit të informacionit të rëndësishëm mbi aktivitete ndërkufitare;
- mundësojnë shkëmbimin e automatizuar të informacionit ndërmjet të gjitha njësive organizative kufitare sipas praktikave më të mira në EU;
- mbrojnë të dhënat adekuate përmes kodeve sigurorese;
- sigurojnë integrimin e sistemeve elektronike për kontrollimin e kufirit, dhe
- lejojnë përdoruesve të autorizuar qasje të vazhdueshëm në burime të caktuara të informacionit.

Njësitë përkatëse për administrimin e të dhënave dhe informacionit në DK, duhet që PKK-ve t'iu përcjellin të dhënat informative dhe informatat e pranuar si nga burimet lokale ashtu edhe ndërkombëtare, të cilat informacione do t'iu shërbenin zyrtarëve doganor si paralajmërim i hershëm dhe sipas udhëzimeve të identifikojnë dhe ndalojnë rreziqet dhe kërcënimet nga kompanitë e dyshimta, mjetet e transportit dhe udhëtarët.

Sa i përket sistemit ASYCUDA World, një ndër objektivat që duhet realizuar janë ndërtimi i profileve efektive të riskut dhe përzgjedhja e dërgesave në mënyrë të automatizuar.

Zyrtarët doganor të sistemuar në PKK duhet të përcjellin informatat kthyesë lidhur me të gjeturat sipas informacionit të pranuar tek njësitë përkatëse për administrimin e informacionit për përpunim të mëtutjeshëm të informacionit dhe rregullisht duhet të paraqesin informatat e pranuar në nivel lokal.

6.1.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Infrastruktura dhe pajisjet mbështesin stafin operacional dhe duhet të jenë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre përkatëse.

Shumica e mjediseve ekzistuese në PKK nuk lehtëson bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve dhe ndërtimi i mjediseve të reja duhet të jetë një prioritet për DK-në. Gjithashtu është i nevojshëm një rishikim i infrastrukturës jo vetëm në PKK por edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganës.

Pajisjet e përdorura nga agjencitë kufitare zakonisht përbëhen nga mjetet themelore dhe speciale. Ato duhet të jenë adekuate dhe në sasi të mjaftueshme për mbikëqyrjen e duhur të kufijve dhe për përpunimin e fluksit të udhëtarëve dhe automjeteve në secilën PKK, pikën e caktuar hyrëse (DPE) dhe PIK. Standardet e pajisjeve duhet të formalizohen nga secila agjenci në përputhje me politikën e përgjithshme të investimeve, e cila merr në konsideratë vëllimin dhe natyrën e trafikut në çdo PKK. Jo çdo PKK apo Stacioni i brendshëm i kontrollit, ka nevojë të jetë i pajisur në mënyrë të barabartë, por standardet minimale duhet të plotësohen, gjithashtu edhe nevojat e PKK dhe stacioneve të brendshme të kontrollit të përcaktuara për procesim të rrezikut të lartë të mallrave duhet të merren parasysh.

Përderisa kufizimet buxhetore janë të zakonshme, planet e investimit nevojitet të sigurojnë që infrastruktura dhe pajisjet adekuate mund të prokurohen në kohën e duhur, duke e bërë përdorimin e shkallës ekonomike. Duhet të hartohen plane/ projekte realiste investimesh për të siguruar që infrastruktura dhe pajisjet e nevojshme të jenë të pranishme, kur për to të dalë nevoja. Këto plane duke përfshirë planet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata duhet të hartohen për Zyrat Doganore dhe PKK-të, njësitë e mbikëqyrjes kufitare, pajisjet për kërkim, infrastrukturë, mjetet e komunikimit, makinat, rrugët, vend parkingjet, etj, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të DK me të vetmin qëllim ofrimin e kushteve sa më optimale për punë për të gjithë personelin doganor.

6.1.3 AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË E KOSOVËS

AUV është themeluar dhe funksionon bazuar në Ligjin e Ushqimit dhe po ashtu në legjislacionin tjetër në fuqi. Aktualisht AUV si agjenci funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Është e organizuar dhe bashkërenduar me njësi organizative (Drejtori) të agjencisë dhe atë në fusha të ndryshme që në një mënyrë apo tjetrën janë të lidhura me realizimin e kontrolleve kufitare nga fusha e veterinarisë dhe fitosanitarisë.

Planifikohet bartja e AUV nga ZKM në MBPZHR dhe kjo praktikë e lëvizjes ndikon negativisht në ngritje të kapaciteteve funksionale dhe profesionale.

Funksionalizimi dhe bashkërendimi i AUV-së në planin horizontal dhe vertikal me standarde evropiane ndikon në paraqitjen stabile të situatës epizotike në Republikën e Kosovës.

6.1.3.1 Korniza ligjore

AUV funksionon bazuar në Ligjin e Ushqimit. Fushëveprimi ligjor i AUV plotësohet nga: Ligji për Veterinën, Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Ligji për Produktet Medicinale Veterinare, Ligji për Mbrojtjen e Bimëve si dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra bazuar në këtë kornizë ligjore e cila lehtëson zbatimin e këtyre ligjeve.

Korniza ligjore e deritanishme është e bazuar në legjislacionin e BE, duhet të vazhdohet në nxjerrjen e akteve nënligjore (rregulloreve) bazuar në legjislacionin BE.

Harmonizimi i kornizës legjislative vendore nga fusha e veterinarisë, fitosanitarisë dhe ushqimit me Acqui Communautaire është objektiv i AUV.

6.1.3.2 Organizimi dhe menaxhimi

Aktualisht AUV është i organizuar në pesë drejtori të cilat udhëhiqen nga drejtorët, pjesë përbërëse e drejtorive janë sektorët të cilat udhëhiqen nga shefat e sektorëve, menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-së, Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Shkencor.

Inspektorati Kufitar Veterinar dhe Fitosanitar vepron brenda Drejtorisë së Inspektoratit të AUV-së.

Struktura organizative bazuar në kornizën ligjore ka themeluar Zyret Rajonale të AUV-së në Republikën e Kosovës. Strukturën organizative të AUV-së e përcakton Rregullorja 03/2010.

Strategjia parasheh kategorizimin e PIK sipas standardeve Evropiane.

6.1.3.3 Procedurat

Aktualisht AUV kontrollet kufitare i kryen bazuar në legjislacionin e aplikueshëm, manuale dhe PSO për kontroll kufitar veterinar dhe fitosanitar. Këto kontrolle i kryen në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Doganën e Kosovës si dhe me subjektet relevante, varësisht nga natyra e veprimeve si p.sh. dërgimi i dërgesave në vende të caktuara (depo doganore), karantinimi i tyre, përkujdesja shëndetësore, mostrimi, analizat dhe në fund varësisht nga rezultatet procedurat tjera për plotësimin e kontrolleve zyrtare.

PSO të përbashkëta (PK,DK ,AUV) janë shumë efikase, duhet të vazhdohet me këtë praktikë të PSO të përbashkëta këto rrisin efikasitetin e kontrollit kufitar dhe përafrojnë procedurat “një ndalje një kontroll”.

Vendoja e Inspektorëve fitosanitar dhe veterinar në PKK, më afër zyrtarëve doganor në PKK, do ta lehtësonte dhe përshpejtonte edhe më shumë procedurat inspektuese fitosanitare dhe veterinare.

Mosefikasiteti i gjykatave kompetente ndikon që edhe AUV të ketë vështirësi në zbatimin e procedurave të përcaktuara ligjore. Kjo vërehet sidomos tek zvarritja e lëndëve për lirim apo jo të kafshëve të gjalla, zvarritje kjo e cila shkakton edhe shpenzime të panevojshme të mjeteve buxhetore. AUV nuk jep gjoba mandatore. Lëndët duke pritur vendimin e gjykatave krijohen shpenzime. AUV vepron drejt harmonizimit të PSO-ve sipas standardeve evropiane.

PSO-të e përbashkëta i kanë bërë më efektive prandalimin dhe luftimin e dukurie negative, prandaj të vazhdohet më shumë me këtë praktikë duke shtuar PSO të reja për çështje specifike.

6.1.3.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

Gjatë procesit të planifikimit dhe riorganizimit të AUV-së është e nevojshme menaxhimi i burimeve njerëzore sipas standardeve të BE. Kjo kërkon përmirësimin e sistemit aktual të planifikimit nga niveli qendror në atë lokal në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira. Kjo strukturë e re do të menaxhojë personelin dhe do të përgatisë përshkrime pune për çdo pozicion dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të punës, në përputhje me standardet e BE-së. Kjo duhet të përfshijë dhe strukturën përgjegjëse për inspektoratin kufitar në raport me Zyret Regjionale. Në kuadër të ristrukturimit të AUV-së, AUV duhet të organizojë një proces përzgjedhjeje të personelit, trajnimi dhe mbështetjeje logjistike si dhe administrim më të mirë të buxhetit.

Aktualisht në AUV tashmë janë të plotësuar shumica e vendeve të punës me pozitë zyrtarë, duhet të ngritet numri i personelit profesional bazuar në planifikime të mirëfillta buxhetore. Trajnimet bëhen varësisht nga natyra e punëve dhe mundësitë buxhetore të kësaj agjencie, duke mos i anashkaluar prioritetet e trajnimeve dhe mundësisht ndarjen proporcionale

të tyre duke përfshirë sa më shumë zyrtarë të trajnuar. Aktualisht trajnimet bëhen duke u bazuar nga donacione të shumta nga jashtë, bazuar në specifikat nga fusha e veterinarisë, fitosanitarisë dhe sanitarisë trajnimet e mirëfillta bëhen jashtë vendit, trajnime këto të cilat në disa raste nuk mund të realizohen për shkak të kostos financiare. Trajnimet duhet të organizohen nga AUV dhe të përfshijnë organizimin e trajnimeve fillestare dhe ri-trajnimeve bazë dhe atyre specifike në përputhjet me kërkesat e BE-së. Pasi caktohen në detyra, inspektorët veterinarë dhe fitosanitar duhet të marrin trajnime rifreskuese për të arritur shkallë më të lartë profesionalizmi. Rekrutimi i personelit duhet realizuar në bazë të ligjit “për shërbyes civil” në mënyrë që të shmangen lëvizjet e papërshtatshme të personelit të trajnuar.

Organizimi i ekipeve mobile për inspektime të mallrave që vijnë në aeroport, stacionin hekurudhor dhe ZD Intereuropa.

Objektiv kryesor i AUV- së për burimet njerëzore mbetet avancimi i tyre konform kërkesave dhe nevojave të kësaj agjencie si dhe trajnimi i vazhdueshëm i tyre.

6.1.3.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Aktualisht në AUV komunikimi është i rregulluar në mënyra dhe forma të ndryshme, si me telefon fiks, telefon mobil zyrtar, internetit, outlook (intranetit i cili nuk funksionon në PIK) .

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në AUV si në planin vertikal ashtu edhe horizontal ka mangësi. Aktualisht në AUV përveç komunikim ditor me TI sipas nevojës organizohen takime të ndryshme në baza ditore, javore, mujore. Në fushën e komunikimit si mangësi paraqiten aspektet teknike si p.sh. mosfunksionimi i rrjetit nëpër pika inspektuese kufitare, këto janë defekte afatshkurta të cilat brenda ditës rregullohet nga kontraktuesi. Me aplikimin e TI-ASYCUDA kjo mund të pengojë shumë. Duhet TI e AUV-së dhe DK-së të jetë e përbashkët.

Duhet të aplikohet CVED dokumenti për komunikim, i cili do të lehtësoj qasjen në TRACES.

Për një funksionim më efikas të komunikimit, AUV ka objektiv përsosjen e vazhdueshme të pajisjeve komunikuese si dhe mirëmbajtjen e tyre, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të kontrollit të punës në pikat inspektuese kufitare.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij parametri luan edhe teknologjia informative. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e TI duhet të jetë prioritet. Integrimi i TI të AUV në TRACES duhet të planifikohet në plan afatgjatë.

Gjithashtu, duhet të ngrihet një bazë e të dhënave në nivel qendror që të ruajë informacionin e marrë në lidhje me: PIK , sistemin e shpejtë të alarmit të BE-së dhe vendeve të tjera. Ky sistem TI i avancuar do të mundësojë në një fazë të dytë përdorimin e sistemit informativ TRACES.

PIK-të janë të pajisura me sistemin e softuerit AUV për futjen e të dhënave ku secili zyrtar mund të komunikoj me Qendrën për Informacione të Ndryshme, përfshirë të hyrat e importit gjatë ditës dhe për të gjitha aktivitetet tjera të kryera në PIK.

Aktualisht AUV posedon me softuerin (INTERTRACE), në të cilin janë të futura të gjitha të dhënat e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, fakt ky që e mundëson përcaktimin e kafshëve të kontrabanduara sepse edhe inspektorët në teren janë të pajisur me PDA, si dhe janë në gjendje që të verifikojnë të dhënat për secilën kafshë të regjistruar. Softueri është ndërtuar si WEB .

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e TI duhet të jetë prioritet i AUV-së.

Mangësitë në fushën e TI janë kryesisht të natyrës teknike me ç'rast krijohen vështirësi komunikimi. Numri i vogël i personelit të specializuar të TI, për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjisë informative krijon vështirësi. AUV duhet të planifikoj ngritje të kapaciteteve profesionale në TI.

6.1.3.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Gjendja e infrastrukturës në PIK është përmirësuar minimalisht kohët e fundit. Aktualisht në të gjitha **PIK** nuk ekzistojnë ambiente të përshtatshme për realizimin e inspektimit kufitar sipas kërkesave të BE-së. Ato gjithashtu nuk krijojnë kushte për bashkëpunimin brenda përbrenda agjencisë dhe me agjenci tjera. Kjo situatë pritet të përmirësohet në vazhdim në kuadër të programeve të ndryshme duke synuar që në një fazë të dytë kushtet e punës të përputhen me kërkesat e BE-së. Buxheti i shtetit duhet të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës së inspektimit kufitar. Duhet të shfrytëzohen donacione nga projekte të ndryshme, si psh IPA.

Aktualisht pajisjet për inspektim kufitar nuk janë të kompletuara plotësisht. Njësia përgjegjëse për menaxhimin dhe organizimin e inspektimit kufitar të AUV-së, do të sigurojë kontroll të drejtpërdrejtë të infrastrukturës dhe pajisjeve dhe do të përcaktojë mënyrën e bashkëpunimit për përdorimin e përbashkët të kësaj infrastrukture dhe pajisjeve. Ndërkohë, kjo strukturë do të mundësojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të gjithë infrastrukturës dhe mjeteve në dispozicion. Mungesa e zyrave të veçanta për inspektor kufitar është evidente (vetëm në PIK Vërmica).

Objektiv i AUV është që inspektorët e tij t'i kenë zyrat e veçanta përfshirë edhe zyrën për pajisje dhe përgatitje të mostrave. Me qëllim të krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efikas të menaxhimit të kufirit, bashkëpunimi i ngushtë në mes të gjitha agjencive të përfshirë është esencial. Ky bashkëpunim nuk duhet të kufizohet vetëm në PKK-të, mirëpo duhet të shtrihet edhe në fushat tjera duke përfshirë edhe nivelin qendror. Në shërbim të kësaj, koordinimi i punëve në mes të PK-së, DK-së dhe AUV-së është i domosdoshëm. Kjo duhet të bëhet me qëllim të rritjes së efikasitetit duke e minimizuar dyfishimin e veprimeve si dhe mospërputhjet. E gjithë kjo do t'i shërbejë objektivit kryesor, për kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.

6.2 BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCIVE

Ekziston bashkëpunim i mirë ndërmjet agjencive, që ka trajtën e një metode horizontale të bashkëpunimit dhe bashkërendimit, ku agjencitë e vendosura në kufi dhe ministritë/autoritetet qendrore përgjegjëse për këto shërbime kanë një bashkëpunimin dhe bashkërendim të mirë. Kjo rezulton me kontaktet e përditshme në nivel qendror dhe atë të PKK-ve (qoftë në nivel zyrtar apo jo zyrtar) dhe më tej vazhdon me koordinim e aktiviteteve në zbatimin e objektivave të dala nga Strategjia për MIK. Ky bashkëpunim ka si qëllim: mundësimin e trajtimit më optimal të çështjeve të tilla praktike si përvijimi i politikave dhe i praktikave, atje ku është e nevojshme, zhvillimi i infrastrukturave të reja dhe gjetja e burimeve financiare për to, mundësia e përdorimit të së njëjtës strukturë (ndërtesë apo shërbim të TI-së), por edhe hartimi i trajnimeve të përbashkëta për personelin ekzistues dhe atë të ri.

Për këto çështje strategjike, janë formuar edhe grupet e përbashkëta punuese ndërmjet agjencive në të gjitha nivelet, me qëllim të zgjidhjeve adekuate të problemeve në një nivel më të lartë dhe të gjetjes së zgjidhjeve adekuate, ku mund të konsiderojmë se ka pasur lëvizje pozitive. Ky bashkëpunim është evident me të gjitha agjencitë e përfshira në MIK mirëpo, edhe me agjencitë tjera shtetërore.

Autoritetet përgjegjëse për MIK, do të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë ngushtë aktivitetet me partnerët relevantë ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, posaçërisht me Komisionin Evropian, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-in dhe me projektet përkrahëse, me qëllim të realizimit të objektivave që dalin nga kjo strategji. E gjithë kjo duhet t'i shërbejë objektivit kryesor për kufij të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt.

Në bazë të dispozitave të reja ligjore, duhet të shtohet bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK dhe të fuqizojnë kapacitetet e tyre për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive dhe të pavarur.

6.2.1 Korniza ligjore

Bazuar në legjislacionin ekzistues, sa i përket bashkëpunimit ndërmjet agjencive janë bërë përmirësime të dukshme dhe legjislacioni aktual është bazë për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve dhe është në harmoni me standardet e BE-së. Ekziston ligji për bashkëpunim ndërmjet agjencive të përfshira në MIK si dhe memorandume bashkëpunimi ndërmjet agjencive, sidoqoftë sipas nevojës do të hartohen dhe miratohen marrëveshje shtesë të cilat do të jenë gjithëpërfshirëse.

Është avancuar bashkëpunimi edhe në fushën e luftimit të krimit ndërkufitar si dhe është bërë ndarja e qartë e përgjegjësisë dhe detyrave posaçërisht në PKK ku nuk janë të përfshira të gjitha agjencitë (kategoria B, C).

Janë avancuar dhe do të vazhdoj fuqizimi i kapacitetetve të qendrës koordinuese për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të përfshira në MIK. Në fushën e shkëmbimit të informatave janë në shfrytëzimin databazat e të dhënave ndërmjet agjencive. Kjo rregullohet me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligjin për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të përfshira në MIK, Udhëzimi Administrativ mbi Funkcionalizimin e Detyrave dhe Përgjegjësisë të QKMK-së.

Sipas nevojës, mund të lidhen marrëveshje edhe me agjencitë tjera relevante të cilat nuk janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në MIK.

6.2.2 Organizimi dhe menaxhimi

Agjencitë e përfshira në MIK, në vazhdimësi ndërmarrin operacione të përbashkëta, mbahen takime të rregullta ndërmjet agjencive. Ekziston nevoja e përfortimit të bashkëpunimit, përmes rritjes së numrit operacioneve dhe hetimeve të përbashkëta, analizës së përbashkët të rrezikut dhe inteligjencës kriminale, kontrollimit më efektiv dhe efikas të personave, automjeteve, mallrave dhe reagueve në situata të jashtëzakonshme. Bëhen planifikime të përbashkëta strategjike, alokim i personelit dhe burimeve teknike bazuar në një analizë të vazhdueshme të mjedisit dhe kërcënimeve. Bëhen planifikime të aktiviteteve për menaxhimin e kufirit të udhëhequra nga inteligjenca e përbashkët.

Për vënien në zbatim të Strategjisë MIK dhe Planit të Veprimit 2013 -2018, duhet të avancohen kapacitetet bashkëpunuese dhe bashkërenduese ndërmjet agjencive përgjegjëse për menaxhimin e kufijve.

Detyrat konkrete për përmbushjen e Strategjisë dhe PV në këtë parametër duhet të përfshijnë:

- Të garantohet që agjencitë organizojnë mbledhje të rregullta në të gjitha nivelet me qëllim zgjidhjen e problemeve, dhënien e asistencës reciproke në zbatimin e detyrave dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta që mbikëqyren nga organi mbikqyrës bordi ekzekutiv.
- Të përmirësohet kontrolli i kufirit (kontrollimet dhe vëzhgimet) në dhe ndërmjet PKK-ve, me theks të veçantë nëpërmes rritjes së analizës së rreziqeve dhe inteligjencës kriminale, për të siguruar kontrollimin e personave, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin dhe vëzhgim efektiv ndërmjet të gjitha pikave kufitare.

6.2.3 Procedurat

Të gjitha agjencitë kryesore të përfshira në MIK i posedojnë PSO-të e përbashkëta të bazuara në ligjet përkatëse.

Procedurat në PKK janë të harmonizuara dhe të thjeshtësuara. Duhet të ngritet bashkëndimi i kontrollit dhe kontrollimeve të përbashkëta në PKK dhe të vazhdohet me organizmin e operacioneve të përbashkëta apo të bashkërenduara me qëllim të sinkronizimit të aktiviteteve. Përpilimi i PSO-ve tjera të bëhet sipas nevojës.

Për të pasur rezultat në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe aktiviteteve të kundërligjshme, duhet të vazhdohet me organizmin dhe zbatimin e veprimeve të përbashkëta bazuar në analizën e riskut. Informacionet e marra nga sistemet e analizës së riskut mund të shërbejnë si bazë për kontrollet me përzgjedhje.

Në situata të ndryshme do të hartohen plane të përbashkëta kontigjente dhe emergjente për zonat kufitare me qëllim të sqarimit dhe ndarjes së përgjegjësive në mes të agjencive në raste të situatave të kërcënimit të sigurisë kombëtare, shëndetit publik ose situatave ekstreme siç janë: katastrofat natyrore, sëmundjet pandemike, fluksit të papritur të refugjatëve, aktiviteteve terroriste, aksidenteve madhore dhe zjarreve madhore që mund të ndodhin në zonën kufitare.

6.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

Sipas gjendjes momentale numri i personelit në agjencitë e autorizuara për MIK nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat ditore. Vështirësitë të cilat shfaqen në terren janë të natyrave të ndryshme.

Duhet të bëhet plotësimi i vendeve të punës sipas strukturës organizative dhe nevojave të agjencive dhe të organizohen trajnime të përbashkëta në vazhdimësi të bazuara në konceptin e MIK-ut dhe standardet evropiane.

Aktivitetet e përbashkëta trajnuese duhet të përfshijnë stafin nga të gjitha agjencitë e menaxhimit të kufirit. Këto aktivitete jo vetëm që ndikojnë në funksion të ndërtimit të besimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informacionit, por ato gjithashtu rezultojnë në përdorim më efikas të burimeve. Qëllimi kryesor i trajnimeve të stafit është në rritje e efektivitetit të asistencës së ndërsjellë dhe për të rritur ndërgjegjësimin ndërmjet autoriteteve të MIK-ut. Kjo mund të arrihet duke zgjeruar njohuritë e oficerëve që bashkëpunojnë dhe për të përmirësuar të kuptuarit e punës së njëri-tjetrit. Para së gjithash zyrtarët e palëve bashkëpunuese duhet të jeni të njoftuar për detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e agjencisë tjetër me të cilën bashkëpunojnë, si dhe dispozitat në lidhje me shkëmbimin e informacionit, se si bashkëpunimi aktual operacional dhe format tjera të bashkëpunimit mund të përmirësohen.

Gjatë trajnimit përfitime të qarta mund të arrihen për të gjitha agjencitë/shërbimet. Aktivitete të përbashkëta trajnuese rezultojë me një përdorim më efikas të burimeve. Mund të jenë trajnime bazik për stafin e ri ose trajnime të vazhdueshme. Trajnimet e përbashkëta janë mënyra më e mirë për të inkurajuar zyrtarët për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira. Trajnimet duhet të jenë të natyrës praktike duke u përqendruar në bashkërendimin e procedurave

Forma të ndryshme të trajnimit ndërmjet agjencive mund të shquhen:

- Trajnim për rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me ose përfshijnë bashkëpunimin me akterët tjerë;
- Trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera për çështje të shqetësimeve të përbashkëta;
- Trajnim për stafin që të njohin detyrat dhe aktivitetet e homologëve të tyre dhe për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet e bashkëpunimit ndërmjet agjencive.

Këto aktivitete trajnuese nuk duhet të synojë vetëm rekrutët e rinj, mirëpo janë pjesë e vazhdueshme e trajnimeve të brendshme dhe përfshijnë si nivelin operacional dhe atë menaxherial të gjitha agjencive. Një trajnim tipik ndërmjet agjencive me qëllim të prezantimit të pjesëmarrësve me agjencitë tjera në kufi do të mbulojnë fushat e mëposhtme:

- strukturën organizative;
- kuadrin ligjor;
- detyrat themelore dhe kompetencat; dhe
- fushat e interesit të përbashkët.

Përveç seancave të lartpërmendura për trajnime të përbashkëta për të gjitha agjencitë, aktivitetet e mëposhtme trajnuese ndërmjet agjencive janë të mundshme:

- Stafin nga agjencitë tjera ftohet të marrin pjesë në trajnimin mbi një temë me rëndësi për më shumë se një agjenci (P.sh. në detyrat e oficerëve ndërlidhës).
- Ndarja e ekspertizës dhe materialeve të trajnimit në mes të agjencive, p.sh. hyrjet-trajnimi i stafit për vizë dhe personelin konsullor për çështje të tilla si ekzaminim/verifikim të dokumenteve dhe intervistim, trajnimin nga shërbimet e inspektimit për personelin doganor mbi procedurat për parandalimin e futjes së organizmave të dëmshëm ose kontrollet anti-kontrabandë për produktet me origjinë shtazore, etj.
- Në disa raste, njësitë e trajnimit mund të përfitojnë vetë nga qendrat e përbashkëta kombëtare të trajnimit. Këto janë qendra të përbashkëta të trajnimit të përdorura nga disa agjenci. Përveç reduktimit të shpenzimeve për agjencitë individuale dhe rritjen e qasjes në burime, këto gjithashtu lehtësojnë shkëmbimin e ideve, krijojnë situata në të cilat stafi i agjencive të ndryshme mund të vijë në kontakt, jozyrtarisht dhe zyrtarisht, dhe

përforcon konceptin e një qasjeje kohezive kombëtare për menaxhimin e kufijve.

Caktimi i personelit në detyrë

Orët e punës së agjencive të menaxhimit kufitar, duke përfshirë shkëmbimin (ndërrimet) e ndërrimeve, duhet të harmonizohen në çdo PKK me qëllim që sipas mundësive të mbahen takime (brifingje) të përbashkëta të udhëheqësve të ndërrimeve. Shkëmbimet e ndërrimeve, të sinkronizuara apo jo, duhet të parashikojnë që të paktën 30 minuta të mbulojnë njëri tjetrin me qëllim që të shmangin ndonjë ndërprerje të procedurave që janë në vazhdimësi dhe të mundësojnë një pranim-dorëzim adekuat/të duhur.

6.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Komunikimi zyrtar në mes të agjencive të MIK-ut, në të gjitha nivelet është në nivel të duhur. Komunikimi ndërmjet agjencive është i rregulluar me doracakun e komunikimit, i cili është fuqizuar me vendim të ministrit të Punëve të Brendshme.

Publiku është i informuar me procedurat e kalimit kufitar, bazuar në doracakun komunikimit ndërmjet agjencive dhe ueb faqen e MIK-ut: <http://www.mpb-ks.org>.

Si objektivi mbetet të avancohet dhe strukturohet komunikimi ndërmjet agjencive edhe me forma të tjera, sipas standardeve të BE-së dhe praktikave të mira, veçanërisht sistemit të paralajmërimit të hershëm (Early Warning System).

Një sistem efektiv i paralajmërimit të hershëm duhet të jenë në vend, qoftë nëpërmjet një sistemi të pikave të kontaktit në agjencitë individuale ose nëpërmjet QKMK-së ose zgjidhjeve përmes TI-së.

Me theks të veçantë duhet t'i kushtohet vëmendje pesë fushave të ndërlidhura të menaxhimit të informacionit dhe shkëmbimit të informacionit, të cilat janë:

- Mbledhja e informacionit;
- Shkëmbimi i informacionit;
- Paralajmërimi i hershëm;
- Analiza e rrezikut;
- Mbrojtja e të dhënave.

Sistemi i shkëmbimit të informacionit duhet të përshkruhet në udhëzimet operative ose në manual, i cili gjithashtu duhet të përfshij forma të standardizuara dhe mostra për raportimin e të dhënave statistikore ose informacioneve. Duke pasur një sistem të harmonizuar të mbledhjes së informatave gjithashtu lehtësohet shkëmbimi i të dhënave dhe bashkëpunimi me agjencitë dhe shërbimet tjera. Pavarësisht nga metoda e përdoruar, (të punuar ose përmes aplikacionit të TI,

shkëmbimi i informacionit me anë të hard-kopjeve ose telefonit) mbrojtja e të dhënave duhet gjithmonë të jetë e garantuar bazuar në legjislacionin në fuqi. (Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij parametri luan edhe teknologjia informative. Në të gjitha PKK-të, është i vendosur sistemi i TI-së, interneti, intraneti, radio komunikimi dhe telefoni fiks, si dhe është i vendosur sistemi i vëzhgimit me kamera TVQM (CCTV) dhe ANPR që kryhet nga QKMK. Në Policinë e Kosovës përdoret sistemi BMS, në Doganën e Kosovës, aplikohet sistemi ASYCUDA World dhe AUV posedon sistemin e softuerit AVUK për futjen e të dhënave, me përjashtim të pikave kufitare.

Tani jemi në proces të integrit të bazave të dhënave ndërmjet agjencive, ku edhe është hartuar dhe miratuar Strategjia e përbashkët për TI-në. Kur kjo strategji ka qenë duke u zhvilluar, hapat e mëposhtëm janë marrë në konsideratë:

- Përputhshmëria;
- Siguria (mbrojtja e të dhënave, rregullimi i qasjes);
- Përgjegjësitë (të dhënat e qasjes, emrat e përdoruesve etj);
- Përshtatshmëria (duke shtuar / ndryshuar komponentët / modulet, përdoruesit etj).

Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i integruar sistemet aktuale të shkëmbimit të informatave dhe vëzhgimit me kamera dhe ANPR dhe ato që do të ngritën në të ardhmen në mënyrë që të bëhet një shkëmbim më efektiv dhe efikas i informatave dhe me më pak shpenzime.

6.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Aktualisht infrastruktura e PKK-ve është përmirësuar dukshëm dhe mbetet si objektivi që edhe në të ardhmen të bëhen përmirësime në infrastrukturë bazuar në kategorizimin dhe standardizimin e PKK/ve, ndërtim të objekteve dhe hapësirave të reja, renovim të objekteve dhe hapësirave ekzistuese.

Objektet e përbashkëta, përdorimi i përbashkët dhe prokurimi i përbashkët i pajisjeve zvogëlon shpenzimet dhe njëkohësisht rritë bashkëpunimin ndërmjet agjencive. Është e nevojshme dhe domosdoshme që të kryhen investime të përbashkëta në PKK dhe ato të jenë të pajisura sipas standardeve të BE-së, me të vetmin qëllim që të ofrojnë dhe sigurojnë qarkullimin e lirë dhe kontrollimin e mirëfilltë kufitar (ndarja e trafikut, ndarja e zonës së kontrollit kufitar, vendosja e shenjave në PKK, etj). Rekomandohet të bëhen vlerësime të rregullta të objekteve ekzistuese dhe pajisjeve, bazuar në identifikimin e nevojave. Kjo përfshin përzgjedhjen e PKK-ve prioritare në koordinim me të gjitha agjencitë e menaxhimit të kufijve, ku burimet duhet të jenë të përqendruara, bazuar në analizat e rrezikut dhe kërcënimeve. Vendimi mbi PKK-të prioritare ose lidhur me përmirësimin e PKK-ve duhet të koordinohet edhe me palët e tjera të interesuara siç

janë Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i Transportit, Sportit të Mallrave dhe Operatorëve përmes përdorimit të një procesi sistematik të analizës së rrezikut strategjik dhe operacional. Gjithashtu, është e rëndësishme që të kryhen konsultime me shtetin/et fqinj/e dhe të merren në konsideratë planet e tyre zhvillimore për PKK-të në fjalë.

Përderisa për ngarkesat komerciale të inspektuara në PIK dhe DPE-s kërkesa të detajuara në lidhje me pajisjet e infrastrukturës dhe teknike duhet të respektohen në mënyrë që të shmangët çdo kontaminim i kryqëzuar në mes të mallrave të kontrolluara, objektet e caktuara mund të ndahet për përdorim të përbashkët në rastin e veterinarisë dhe ushqimit. Sipas infrastrukturës në dispozicion për një PIK, ajo mund të miratohet për produkte të caktuara të kafshëve ose vetëm për gamën e plotë të produkteve shtazore (në ambient, temperatura të ftohta dhe të ngrira), si dhe për lloje të ndryshme të kafshëve të gjalla (thundrakëve (U), të regjistruara njëthundrrakët (E) ose kafshëve tjera (O).

Për PIK të aprovuara për kontrollet e kafshëve të gjalla duhet të jetë një korsi e veçantë e trafikut në hapësirat e PIK, për të shmangur periudhat e panevojshme të pritjes për kafshët e gjalla që duhet të kontrollohen.

Përdorimi i përbashkët i pajisjeve, shfrytëzimit i përbashkët i objekteve, mundësia e shfrytëzimit dhe ndarjes së pajisjeve, duhet gjithmonë të merret në konsideratë.

Krijimi i një zyre bashkërenduese ndër-ministrore të prokurimit të përbashkët, mund të ndihmojë për të kursyer kostot duke e bërë përdorimin e shkallës dhe leverdisë ekonomike. Aty ku kjo nuk është e mundur, një nga agjencitë kufitare mundet që me kërkesë për mallra të veçanta të interesit të përbashkët, të marrë përsipër përgjegjësinë e dhënies së procedurës së tenderimit në emër të të gjitha agjencive të kufirit.

6.3 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

6.3.1 POLICIA KUFITARE

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në menaxhimin e kufirit, është shumë i rëndësishëm edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Ky bashkëpunim më së miri mund të bëhet përmes shkëmbimit të informatave, përcaktimit të procedurave emergjente dhe kanaleve të komunikimit.

PK-ja synon që ta avancojë bashkëpunimin ndërkombëtar në të tri nivelet: atë multilateral, bilateral dhe lokal. Po ashtu, PK synon që të kyçet më aktivisht në proceset multilaterale të bashkëpunimit evropian, përmes pjesëmarrjes aktive në grupet relevante punuese të procesit të Budapestit.

6.3.1.1 Korniza ligjore

Aktualisht, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, PK-ja bazohet në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkuara me vendet fqinje, si me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Jemi në proces të miratimit të marrëveshjeve për bashkëpunim policor edhe me Malin e Zi, ndërsa me Republikën e Serbisë është arritur marrëveshja me ndërmjetësimin ndërkombëtar në Bruksel për MIK dhe lëvizjen e lirë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë edhe marrëveshjet bilaterale për demarkacionin e vijës kufitare me vendet fqinje Demarkacioni i kufirit shtetëror me Maqedoninë ka përfunduar, ndërsa me Malin e Zi është në proces. Është shumë e rëndësishme që të arrihet marrëveshja për mbikëqyrje të Kufirit të Gjelbër-Kaltër edhe me Republikën e Serbisë me qëllim të avancimit të menaxhimit të kontrollit të kufirit, pasi që kjo është në interes të dyanshëm, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës ka vijën më të gjatë të kufirit me këtë Republikë.

Është arritur përparim i dukshëm në fushën e patrullimeve të përbashkëta me Policinë e Shqipërisë dhe Maqedonisë, si dhe patrullime të sinkronizuara me Malin e Zi.

Synim afatshkurët është miratimi dhe zbatimi i marrëveshjes për bashkëpunim policor ndërkufitar me Republikën e Malit të Zi.

Synim tjetër është arritja e një marrëveshjeje e bashkëpunimit me FRONTEX.

Po ashtu, Policia Kufitare synon të jetë pjesë aktive e iniciativave dhe mekanizmave rajonal dhe ndërkombëtar të bashkëpunimit policor ndërkufitar si psh. Konventa e Vjenës për sigurinë e Kufirit në Evropën Juglindore, DCAF, etj.

6.3.1.2 Organizimi dhe menaxhimi

Në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare ekzistojnë Divizioni për Kontroll dhe Mbikëqyrje të Kufirit dhe Divizioni për Menaxhim të Integruar të Kufirit, si dhe Zyra për Bashkëpunim Ndërkufitar. Policia Kufitare mban takime ndërkufitare të nivelit lokal, rajonal dhe qendror, që janë takime të rregullta. Me Shqipërinë aktualisht takimet e të gjitha niveleve mbahen në bazë të Protokollit të miratuar për organizimin e takimeve të tilla. Mbetet që protokolle të këtij lloji të miratohen edhe me vendet tjera. Në këtë fushë PK synon të jetë më aktive sa i përket marrëdhënieve bilaterale duke avancuar kontaktet me shërbimet kufitare të shteteve fqinje duke i dhënë prioritet.

Takimet me Republikën e Serbisë, në bazë të marrëveshjes mbahen në baza mujore në nivel rajonal, ndërsa në nivel qendror në baza gjashtë mujore.

Kjo synohet të bëhet, fillimisht duke caktuar personat e kontaktit (në ato vende ku nuk janë caktuar ende) pastaj hapjen e qendrave të përbashkëta të kontaktit dhe shkëmbim të informacionit. Me këtë do të sigurohej shkëmbim efikas i informatave dhe atë jo vetëm për nevojat e PK-së, por kjo do t'u ndihmonte edhe agjencive dhe institucioneve tjera brenda Republikës së Kosovës, siç janë: Policia e Kosovës, Dogana, Gjykata, etj.

Synim tjetër mbetet hapja e PKK-ve të reja me shtetet fqinje, sipas vlerësimit të nevojave dhe marrëveshjeve bilaterale.

6.3.1.3 Procedurat

Korniza ligjore që ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtarë brenda të cilës operon PK është e kënaqshme, mbetet synim të arrihen marrëveshje bashkëpunimi edhe me vendet tjera.

Po ashtu, në këtë fushë duhet pasur parasysh edhe situatën aktuale, e cila është specifike në Republikën e Kosovës, posaçërisht sa i përket vijës së gjelbër dhe të kaltër të kufirit me Serbinë, e cila është ende në përgjegjësi të plotë të KFOR-it.

Synim i PK –së është marrja e plotë e përgjegjësisë nga KFOR-i , për mbikëqyrje të kufirit të gjelbër dhe të kaltër me Republikën e Serbisë.

Synim tjetër i PK-së, është hartimi i procedurave standarde të veprimit me agjencitë e vendeve fqinje dhe vendeve tjera.

PK tani më realizon patrullime të planifikuara të përbashkëta me Maqedoninë dhe Shqipërinë, dhe patrullime të sinkronizuara me Malin e Zi. Në vazhdimësi mbetet synim i PK që të shtohen numri i patrullimeve të përbashkëta të vijës kufitare dhe se kjo të bëhet gradualisht me ndryshimin e rrethanave (kalimi i përgjegjësisë nga KFOR-i tek PK-ja, sa i përket vijës së

gjelbër dhe kaltër me Serbinë), si dhe me ripërtëritjen e marrëveshjeve ekzistues dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me vendet fqinje.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të menaxhimit të kufirit, PK synon që në të ardhmen të hartoj plane të përbashkëta operacionale dhe plane të veprimit në rast të situatave të ndryshme dhe sistem të komunikimit emergjent me vendet fqinje.

6.3.1.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

PK ka mungesë të burimeve njerëzore dhe ekziston nevoja për një rritje të ndjeshme të burimeve njerëzore në kuadër të PK-së.

Zyrtarët e PK-së marrin pjesë në disa trajnime të cilat mbahen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), sidoqoftë trajnimet që organizohen dhe të cilat i ndjekin zyrtarët e PK-së i plotësojnë nevojat e shërbimit dhe shpeshherë organizohen trajnime, seminare, punëtorive pune dhe vizitave të ndryshme studimore jashtë vendit dhe anasjelltas, të mbështetura dhe financuara nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Trajnime dhe seminare me pjesëmarrje ndërkombëtare, vizita studimore dhe shkëmbim të programeve për zyrtarët janë mjete për të mësuar në lidhje me praktikatat e vendeve të tjera dhe të nxiten kontakte me homologët.

Ky synim mund të arrihet edhe duke ftuar homologët nga vendet tjera ose direkt në PKK në fjalë.

Organizimi i kurseve trajnuese specifike për MIK duke përfshirë në seancat e trajnimit për kufi të personelit vendor dhe shtetet fqinje në qendrat e trajnimit vendor apo ndërkombëtar në një kontekst shumëpalësh, duke lejuar zyrtarët nga shërbimet e ndryshme kufitare në shtete të ndryshme me qëllim që të mësojnë lidhur me konceptin e MIK-ut, si dhe për të shkëmbyer praktikatat e mira dhe përvojat.

Informata themelore për autoritetet ekuivalente të vendeve fqinje, duke përfshirë edhe sfondin e përgjithshëm legjislativ, kornizën institucionale dhe procedurat operative, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duhet të jenë pjesë e programit mësimor për oficerët e rinj dhe inspektorët në mënyrë që të rritet mirëkuptimi i ndërsjellë.

Kudo që ekzistojnë forume rajonale të përshtatshme, ata mund të punojnë në drejtim të formimit të etapave dhe standardeve të trajnimit rajonal duke përfshirë qendrat rajonale të trajnimit, kushtet e përbashkëta të referencës dhe kualifikimeve të trajnerëve, si dhe në standardizimin e kurrikulave dhe materialeve të trajnimit.

Sido qoftë mbetet nevojë e përhershme organizimi i trajnimeve që ndërlidhen në mënyrë direkte me punën e zyrtarëve të PK-së, është shumë e rëndësishme të organizohen edhe trajnime të

gjuhëve, siç janë: gjuhë angleze, maqedonase, si dhe në gjuhën serbe, me qëllim të rritjes së shkathtësive të komunikimit në mes të zyrtarëve të PK-së me zyrtarët e vendeve fqinje.

Gjuha angleze është posaçërisht e rëndësishme për pjesëmarrje në nivel ndërkombëtar. Po ashtu, duhet të organizohet trajnime të specializuara edhe në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit, njohurive për Schengen, trajnimeve në fushën e krimit transnacional, si dhe trajnimeve të përbashkëta me pjesëtarët e Policisë Kufitare të vendeve fqinje si dhe vendeve tjera të rajonit dhe më gjerë, me qëllim të shkëmbimit të praktikave më të mira.

PK është gjithëpërfshirëse sa i përket gjinisë dhe përkatësisë etnike, po ashtu ajo vazhdon të fuqizojë pjesëmarrjen në këtë proces.

6.3.1.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Komunikimin me agjencitë policore dhe agjencitë tjera të shteteve të rajonit dhe më gjërë, PK-ja e ushtron në mënyra të ndryshme duke filluar nga takimet e rregullta si dhe përmes zyrave për bashkëpunim që janë në kuadër të Policisë së Kosovës dhe Policisë Kufitare dhe qendrave të përbashkëta për shkëmbim të informacionit.

Synohet që në të ardhmen të kemi komunikim të drejtpërdrejt me autoritetet kufitare të shteteve fqinje (radio dhe telefoni fikse).

Po ashtu, do të shikohet edhe mundësia e shkëmbimit të raporteve javore si dhe raporteve ad hoc, me qëllim të monitorimit sa më të mirë të situatës në kufij.

Do të shikohet edhe mundësia e intensifikimit të takimeve bilaterale, si dhe atyre rajonale me qëllim të paraqitjes së pozicioneve të përbashkëta dhe harmonizimit të politikave që kanë të bëjnë me MIK.

PK me qëllim që të këtë një komunikim sa më efikas dhe efektiv, synon të jetë anëtare e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit policor si p.sh. FRONTEX, EUROPOL, INTERPOL, etj.

Gjendja aktuale në PK sa i përket teknologjisë informative plotëson nevojat por mbetet të përmirësohet dhe zhvillohet në vazhdimësi. Janë disa pajisje të cilat plotësojnë kushtet deri në një masë të madhe. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Teknologjisë Informative e cila është edhe përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve të teknologjisë informative, është në nivel të kënaqshëm dhe çdo kërkesë nga PK-ja merret me prioritet për shkak të specifikave të punës që ushtron ajo.

Një ndër qëllimet kryesore do të jenë marrëveshjet e bashkëpunimit për lejimin e përdorimit të aseteve në mes të dy vendeve fqinjë. Aktualisht një përdorim i përbashkët i sistemeve për menaxhimin e kufirit ekziston vetëm me Shqipërinë (integrimi i sistemeve BMS dhe TIMS).

6.3.1.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Nga 17 PKK kushtet rreth infrastrukturës rrugore, objekteve dhe pajisjeve janë të mira, ndërsa në PKK-të përgjatë kufirit me Republikën e Serbisë dhe me Malin e Zi, ku për objekt zyrtarët policor shfrytëzojnë kontejnerët.

Sa i përket PKK-ve të trafikut hekurudhor nga dy sa janë vetëm një kontrollohet nga PK-ja ajo në Han të Elezit, kurse ajo në Jarinje- Leshaku kontrollohet në bashkëveprim me EULEX-in.

Objektiv për të ardhmen është që të ndërtohen objekte funksionale të përbashkëta së bashku me agjencitë tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që shërbejnë në PKK. Mbështetur nga komisioni Evropian është në proces ndërtimi i PKK-ve të përbashkëta me Maqedoninë në Stanqiq-Bellanovc.

Synim i PK-së është edhe ndërtimi i 6 PKK me Serbinë dhe pajisja e tyre të përbashkëta me Republikën e Serbisë të parapara me konkluzionet e arritura në Bruksel për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ku është projekt i BE-së. Objekte të tilla të përbashkëta pritet të ndërtohen edhe në kufirin me Malin e Zi.

6.3.2 DOGANA E KOSOVËS

Me qëllim të lehtësimit të tregtisë legjitime në njërën anë dhe të parandalimit dhe luftimit të kontrabandës së mallrave, narkotikëve, armëve, mallrave tjera të ndaluara dhe të kufizuara, Dogana e Kosovës ka vendosur një bashkëpunim të mirë me autoritetet doganore të vendeve fqinje të cilat bazohen në marrëveshjet bilaterale ndër-qeveritare për ndihmë administrative në çështje doganore.

6.3.2.1 Korniza ligjore

Kodi Doganor dhe i Akcizave, parasheh bashkëpunim për çështje doganore dhe ato që ndërlidhen me shkëmbimin e informatave rreth mallrave, kontrabandimit, krimit ndërkufitar dhe procedurave që duhet ndjekur.

Dogana e Kosovës ka iniciuar 24 marrëveshje bilaterale për bashkëpunim të ndërsjellë në çështje doganore: 10 nga to janë nënshkruar, ndërsa 14 të tjera janë në fazën e negocimit të tekstit të marrëveshjeve apo në pritje të konfirmimit të datës së nënshkrimit. Marrëveshjet e finalizuara parashohin edhe krijimin e grupeve hetuese dhe kontrollin e dërgesave, sipas legjislacionit të vendeve nënshkruese. Përmes këtij mekanizmi administratat doganore krahas edhe legjislacionit në fuqi, lehtësojnë procedurat doganore, si dhe zhvillojnë hetime të përbashkëta si dhe vëzhgime. Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim të ndërsjellë në mes të agjencive të kufirit dhe agjencive kufitare të shteteve fqinje është masë e domosdoshme, me qëllim të rregullimit të çështjeve me interes të përbashkët, të cilat mund të kontribuojnë në lehtësimin e tregtisë, parandalimin dhe zbulimin e kontrabandës së mallrave dhe njerëzve, si dhe shkeljeve të tjera administrative. Marrëveshjet e tilla duhet të sigurojnë:

- mënyrën e bashkëpunimit, duke përfshirë harmonizimin e procedurave të punës dhe kohës së punës;
- përdorimin e përbashkët të pajisjeve teknike dhe hapësirës;
- trajnime të përbashkëta;
- shkëmbimin e informatave;
- ndihma në zbulimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve;
- bashkëpunimin profesional;
- promovimin e kushteve për sigurimin e qarkullimit të lirë të udhëtarëve dhe të mallrave të ligjshme;
- përdorimin e ndërsjellë të bazës së të dhënave;
- plane të përbashkëta të paparashikuara (alternative);
- oficerë ndërlidhës/persona kontaktues midis vendeve;
- informacione mbi metoda dhe praktikave të reja të punës.

Republika e Kosovës nuk ka nënshkruar ende Marrëveshjen për Stabilizim Asociim me Komisionin Evropian përmes cilës marrëveshje do krijoheshin mundësi për bashkëpunim doganor me Komisionin Evropian. Është e nevojshme të vendoset një bashkëpunim më i mirë me shërbimet doganore të BE-së dhe vendet e “treta”, me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të parregullësive dhe mashtrimeve në fushën e aktiviteteve ndër-kufitare. Një bashkëpunim i tillë do t’i mundësonte DK-së informacion mbi standarde të BE-së dhe në këtë mënyrë t’i ndihmohej DK-së edhe në formën e këshillave dhe trajnimit për të arritur ato standarde.

Është e nevojshme të sigurohet e gjithë infrastruktura ligjore sipas së cilës DK do të mund të anëtarësohej si anëtare e organizatave të ndryshme në nivel ndërkombëtar, i cili synim është i një rëndësie të madhe për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale dhe moderne. DK në bashkëpunim me ministritë tjera relevante ka deponuar instrumentin e anëtarësimit në Organizatën Botërore të Doganave (OBD). Njëkohësisht është dërguar kërkesa për qasje në aktivitetet e organizuara nga OBD, proces ky i ndarë nga anëtarësimi, mirëpo mbeten dy çështje ende të hapura.

Në kuadër të shkëmbimit të informatave për luftimin e krimit ndërkufitar, realizimin e operacioneve të përbashkëta si dhe inicimin e hetimeve të përbashkëta, mbetet e një rëndësie të veçantë pjesëmarrja apo anëtarësimi në organizatën rajonale SELEC (South East Law Enforcement Center).

Me qëllim të lehtësimit të tregtisë si dhe thjeshtëzimit të procedurave doganore, Dogana e Kosovës do të hulumtoj të gjitha mundësitë për anëtarësimin në Konventat Ndërkombëtare.

6.3.2.2 Organizimi dhe menaxhimi

Takime të rregullta mujore zhvillohen në nivelin lokal në mes të shërbimeve kufitare (jo me të gjitha shtetet). Mbahen takime edhe në nivelin bilateral me përfaqësuesit e shteteve fqinje për çështje kufitare me iniciativë dhe organizim të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që janë të pranishme në këto shtete. Janë mbajtur dhe mbahen takime edhe në nivelin e bashkëpunimit multilateral për çështjet e MIK-ut të cilat po ashtu organizohen nga faktori ndërkombëtar.

T’i kushtohet më shumë vëmendje definimit të nevojave dhe qëllimeve të doganës në kuptim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe me qëllim të avancimit të këtij bashkëpunimi. Të vendoset bashkëpunim me shërbimet doganore të Bashkimit Evropian si dhe organizatat tjera ndërkombëtare, duke u kyçur në aktivitetet ndërkombëtare të kryera nga këto shërbime. Gjithashtu është e nevojshme të inkurajohet bashkëpunimin në nivel operativ.

Me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të tregtisë së paligjshme të mallrave, është e nevojshme

të miratohen metodat operative dhe fleksibile të cilat do të mundësonin shkëmbimin e shpejtë dhe efikas të informacionit në lidhje me lëvizjen e mallrave dhe të dokumenteve. Në këtë kuptim, është e nevojshme të krijohen qendra bashkëpunimi në të cilat do të mund t'i kryenin aktivitetet e tyre agjencitë kufitare që veprojnë në kufi dhe ato të vendeve fqinje duke pasur parasysh praktikat dhe procedurat në vendet e BE-së, (një nga praktikat evropiane të njohura si qendra për bashkëpunim, janë qendrat për bashkëpunim ndërmjet Policisë dhe Doganës).

Është e nevojshme që të vazhdohet dhe intensifikohet mbajtja e takimeve të rregullta të nivelit më të lartë të menaxhimit, nivelit lokal në mes shërbimeve të ndryshme të përfshira në veprimtaritë ndërkufitare në Republikën e Kosovës si dhe vendet e saj fqinje. Rëndësia e kontakteve joformale në mes zyrtarëve në të dy anët e kufirit nuk duhet nënvlerësuar dhe dekurajuar.

6.3.2.3 Procedurat

Pas ratifikimit të marrëveshjeve me vendet e rajonit ka filluar implementimi i plotë i tyre, përfshirë edhe shkëmbimet e inteligjencës dhe shkëmbimet e kritereve të profilizimit të ngarkesave të dyshimta, si hap i parë në harmonizimin e procedurave të teknikave të zbatimit të ligjit.

Shërbimet doganore në të dy anët e kufirit të njëjtë dhe shërbimet doganore në nivel ndërkombëtar, duhet të informojnë njëra-tjetrën për standardet vendosura për dokumentacionin dhe kontrollet fizike, në mënyrë që të harmonizohen procedurat e tyre operative në masën më të madhe të mundshme, duke respektuar kuadrin ligjor dhe përgjegjësitë. Në këtë mënyrë, nuk do të dyfishoheshin aktivitetet (punët), do të shkurtohej koha e zbatimit të procedurave doganore dhe do të reduktoheshin ndjeshëm shpenzimet.

Informatat dhe të dhënat inteligjente për të parandaluar mashtrimet do të duhej shkëmbyer në mënyrë rutinore ndërmjet shërbimeve dhe sipas kërkesave zyrtare. Doganat në të dy anët e kufirit duhet të krijojnë plane të përbashkëta emergjente dhe të harmonizojnë kohën e punës dhe të bashkërendojnë aktivitetet të cilat janë në harmoni me standardet dhe praktikat e BE-së.

6.3.2.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

Në kuadër të Doganës së Kosovës funksionon Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar i cili bazuar në marrëveshjet e nënshkuara është pikë kontakti për zbatimin e tyre, përfshirë edhe pjesën e trajnimeve. Gjithashtu, ky sektor synon të bashkërendoj aktivitetet ndërkombëtare me sektorin e MIK si dhe sektorin e trajnimeve. Janë organizuar trajnime të përbashkëta rajonale me iniciativa të administratave doganore, përmes projekteve të asistencave teknike të financuara nga Komisioni Evropian, EXBS, ICITAP, me iniciativë të Doganës së Francës, të Doganës së Italisë dhe organizatave tjera ndërkombëtare.

Dogana e Kosovës merr pjesë në iniciativa rajonale si dhe në Customs 2013, program i Komisionit Evropian. Si pasojë e mosanëtarësimit në organizata ndërkombëtare siç është OBD, SELEC, Balkan Info System etj, DK nuk merr pjesë në trajnime të organizuara nga ta. E një rëndësie të veçantë është vendosja e kontakteve të mirëfillta me këto organizata. E një rëndësie të madhe do jetë që të gjitha doganat të kenë numër të mjaftueshëm të oficerëve të kualifikuar për pjesëmarrje në bashkëpunim ndërkombëtar. Oficerët e angazhuar në bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërkufitar (MIK), duhet të kenë autoritet të mjaftueshëm dhe t’iu mundësuar pjesëmarrjeje aktive në aktivitete ndërkombëtare (takime, seminare, punëtori, etj). Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar vëmendje e veçantë duhet të i kushtohet organizimit të takimeve bilaterale dhe multilaterale me vetiniciativë apo përmes projekteve të financuara nga donatorët.

Një ndihmë të madhe në kryerjen e detyrave punuese në mënyrë profesionale është organizimi i trajnimeve të përbashkëta ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në aktivitetet ndërkufitare në Republikën e Kosovës me qëllim të njoftimit me politikën, standardet dhe procedurat për mbrojtjen dhe kontrollin e kufijve. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë njohjen me detyrat dhe përgjegjësitë e secilit shërbim dhe qëllimit për të përmirësuar bashkëveprimin e tyre të përditshëm. Organizimi i kurseve trajnuese specifike për MIK duhet të konsiderohen në një kontekst shumëpalësh, duke lejuar zyrtarët nga shërbimet e ndryshme kufitare në shtete të ndryshme me qëllim që të mësojnë lidhur me konceptin e MIK-ut, si dhe për të shkëmbyer praktikën e mira dhe përvojat. Informata themelore për autoritetet ekuivalente të vendeve fqinje, duke përfshirë edhe sfondin e përgjithshëm legjislativ, kornizën institucionale dhe procedurat operative, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duhet të jenë pjesë e programit mësimor për oficerët e rinj dhe inspektorët në mënyrë që të rritet mirëkuptimi i ndërsjellë. Kudo që ekzistojnë forume rajonale të përshtatshme, ata mund të punojnë në drejtim të formimit të etapave dhe standardeve të trajnimit rajonal duke përfshirë qendrat rajonale të trajnimit, kushtet e përbashkëta të referencës dhe kualifikimeve të trajnerëve, si dhe në standardizimin e kurrikulave dhe materialeve të trajnimit. Me qëllim të lehtësimit të komunikimit ndërmjet homologëve ndërkombëtar, kurset përkatëse duhet të ofrohen për gjuhë prioritare (zakonisht ato të vendeve fqinje plus anglisht) për stafin që ju nevojitet për punën e tyre të përditshme.

Është e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur të gjenden mënyra për të marrë pjesë në trajnime ndërkombëtare për administratat doganore. Gjithashtu, është e nevojshme vendosja e një sistemi për menaxhimin e trajnimeve, përfshirë edhe e-trajnimet.

6.3.2.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Komunikimi me agjencitë kufitare të shteteve rajonale ndryshon varësisht prej shteteve. Me shumicën e shteteve fqinje komunikimi zhvillohet në të gjitha nivelet e mundshme, ndërsa me pjesën tjetër, përfshirë edhe vendet e treta bëhet vetëm shkëmbimi i informatave me karakter zyrtar dhe atë sa i përket krimit ndërkufitar, emigrimit të paligjshëm, kontrabandimit të mallrave, terrorizmit, etj.

Me qëllim të implementimit të marrëveshjeve me vendet e rajonit janë vendosur komunikime në 3 nivele: niveli qendror/menaxherial, niveli sektorial dhe niveli lokal. Në mënyrë që të rritet efikasiteti në lehtësimin e tregtisë legale, mbahen takime të rregullta të nivelit lokal, për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë informale dhe kriminalitetit, shkëmbehen informacione në baza ditore dhe mbahen takime të rregullta, ndërsa për çështje të hapura, propozime dhe vendosje të politikave dhe strategjive të administratave realizohen takime dy herë vit mes nivelit të menaxherëve të lartë.

Për të siguruar komunikim efektiv dhe efikas është e nevojshme të bashkërendohen aktivitetet dhe veprimet si më poshtë:

- mbajtja e takimeve të rregullta mes zyrave doganore në të dy anët e kufirit;
- krijimi i pikave të kontaktit në pikë kalimet kufitare;
- avancimi i telekomunikimit;
- zhvillimi dhe avancimi i standardeve dhe programeve të TI-së;
- shkëmbimi i të dhënave në mes të sistemeve të ndryshme të komunikimit në harmoni me standardet e BE-së.

Objektiv i DK-së është intensifikimi i komunikimit bilateral dhe ngritja e nivelit të komunikimit dhe shkëmbimit të informatave për të gjitha fushat.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij parametri luan edhe teknologjia informative. Në kuadër të Projektit IPA (Multi-Beneficiary) gjithë administratat doganore të rajonit përfitojnë nga Projekti SEED për shkëmbim elektronik të dhënave në para-arritje, që ka për qëllim lehtësimin e tregtisë dhe identifikimin e ngarkesave të dyshimta. Përmes këtij projekti janë standardizuar informacionet që shkëmbehen në baza bilaterale me secilin vend të rajonit, me përjashtim të Serbisë, ku ka mungesë të theksuar të shkëmbimit të dhënave.

Sistemet e integruara dhe teknologjia e informacionit duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që të përfshijnë informacione nga të gjitha shërbimet (agjencitë), të cilat do të mund të përdoren në nivele të ndryshme të qasjes dhe të mundësonin një shkëmbim të shpejtë të informatave. Sistemet e TI-së duhet të krijohen në atë formë për të siguruar një funksionim të duhur të analizës së përbashkët të rrezikut dhe mbështetje të procedurave, me qëllim të parandalimit të parregullsive dhe mashtrimeve në të dy anët e kufirit dhe në nivel ndërkombëtar. Ky sistem duhet të ofrojë informacione mbi personat, mallrat dhe automjetet dhe të:

- siguroj komunikim në nivele të ndryshme të informacionit dhe që janë të transmetueshme;
- krijimi i një baze qendrore të dhënash;
- siguroj një sistem efikas dhe me kohë të mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit mbi të gjitha aktivitetet kufitare;
- mundësoj në mënyrë të automatizuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet të gjitha njësive kufitare;

- mbrojtje në mënyrë adekuate të dhënave; dhe
- mundësi për të gjithë përdoruesit e autorizuar qasje të vazhdueshme në burimet e informatave të caktuara.

Krijimi i një sistemi të paralajmërimit të hershëm me shërbimet doganore të vendeve fqinje për të zbuluar në kohë dhe parandaluar aktivitetet kriminale ndër-kufitare. Ky sistem do të vendoset në të gjitha nivelet, nivelin lokal - një sistem i komunikimit të drejtpërdrejtë, ndërsa në nivelin qendror përmes komunikimit digjital të mbrojtur.

6.3.2.6 Infrastruktura dhe pajisjet

Ngritjen e standardeve të PKK-ve në nivel më të lartë do duhej bashkërenduar me vendet fqinje në nivel rajonal/ dypalësh. Në një fazë të mëvonshme bashkëpunimi do duhej zhvilluar në drejtim të ngritjes së infrastrukturës së përbashkët. Si element i rëndësishëm duhet të merret parasysh edhe statusi i ardhshëm i kufijve kombëtar dhe të identifikohen ata si kufij afat shkurtër, afat-mesëm apo afat-gjatë nga pikëpamja e zgjerimit të ardhshëm të BE-së, me qëllim që të mos shpenzohen mjete në diçka që në të ardhmen nuk do të mund të shfrytëzohet. Janë bërë përgatitjet fillestare për ndërtimin e objekteve të përbashkëta me Maqedoninë, PKK Stanqiq – Bellanovc si dhe bisedimet me Malin e Zi për PKK Kullë & Kuqishtë.

Bazuar në konkluzionet e dakorduara për MIK e arritur me ndërmjetësimin ndërkombëtar në Bruksel në kufirin me Republikën e Serbisë parashihet ndërtimi i gjashtë (6) objekteve të përbashkët në Pikat e Kalimit Kufitar.

Objektiv për të ardhmen është përmirësimi, zhvillimi i infrastrukturës, ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja në PKK, si dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme për punë.

6.3.3 AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË

6.3.3.1 Korniza ligjore

Objektivi kryesor është harmonizimi i kornizës ligjore në lidhje me kontrollet ndërkufitare bazuar në legjislacionin e BE-së. Në të njëjtën kohë, do të miratohet legjislacioni veterinar dhe fitosanitar për zgjerimin e bazës aktuale ligjore për bashkëpunim ndërkombëtar. Marrëveshjet me vendet fqinje për problemet veterinare-fito-sanitare janë të rregulluara me marrëveshje ndërmjet institucioneve dhe strukturave homologe, ku përcaktohen procedurat teknike dhe detyrimet e ndërsjella për zbatimin e tyre.

Aktualisht korniza ligjore kombëtare nuk paraqet pengesë për bashkëpunim ndërkombëtar për marrëdhëniet midis palëve. (vlenë të theksohet se është e nevojshme dhe po bëhet përpjekje për themelimin e një zyre në kuadër të AUV për bashkëpunim ndërkombëtar e cila konsiderohet një urë lidhëse e aspiratave të AUV për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare respektive).

AUV ka një bashkëpunim me pikat inspektuese kufitare të shteteve fqinje përveç me Republikën e Serbisë, bashkëpunimi është i domosdoshëm veçanërisht në paralajmërimin dhe raportimin zyrtar të sëmundjeve të kafshëve, obligim ky i autoriteteve kompetente të gjitha shteteve të rajonit dhe më gjerë.

Veç kësaj, për shkak të specifikave në fushën e veterinarisë, kjo agjenci bashkëpunon ngushtë edhe me OIE, DG-SANCO, EFSA, FAO, TAIEX, USAID, KSBS, USDA, WHO, WORLD BANK, ECO, me të cilat shkëmben informacione për situatën epizootike. Bëhen përpjekje për anëtarësim të Kosovës në këto organizata dhe për momentin AUV është në disa mekanizma në cilësinë e vëzhguesit.

6.3.3.2 Organizimi dhe menaxhimi

Një tjetër objektivi kryesor është harmonizimi i kuadrit të inspektimit kufitar me atë të vendeve fqinje, me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Për këtë qëllim, statusi i vendinspektimeve kufitare, në të dyja anët e kufirit duhet të bashkërendohet përsa i përket kapacitetit dhe kategorive të inspektimit kufitar veterinar dhe fitosanitar. Bashkëpunimi me BE dhe vendet fqinje që lidhet me shëndetin e kafshëve-bimëve, duhet intensifikuar, duke siguruar shkëmbim të shpejtë të informacionit të nevojshëm, sidomos në lidhje me analizën e riskut. Një qëllim tjetër është bashkërendimi efikas i kontrolleve dhe i operacioneve të përbashkëta që synojnë parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm për shtazët-bimët dhe produktet e tyre. Me qëllim realizimin e bashkëpunimit rajonal dhe bashkërendimit ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor me fqinjët e tyre, duhet të ndërmerret një nismë për një platformë rajonale të MIK.

AUV synon ngritjen e bashkëpunimit profesional me autoritete kompetente veterinarë-fitosanitare ndërkombëtare, duke krijuar kështu një ambient më të sigurt sa i përket sëmundjeve të kafshëve-bimëve dhe sigurisë së ushqimit.

6.3.3.3 Procedurat

Procedurat e inspektimit veterinar dhe fitosanitar kufitar në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe veprimtaritë ndërkufitare janë duke u përshtatur me legjislacionin e BE-së dhe praktikatat e mira të punës.

Bashkëpunimi ndërkufitar lehtësohet me marrëveshjet me vendet fqinje dhe do të lehtësohet më shumë me shtimin e marrëveshjeve dhe prezantimin e procedurave të standardizuara.

Aktualisht AUV nuk ka procedura të përcaktuara për bashkëpunim ndërkombëtar me përjashtim të obligimeve ligjore për lajmërimin e sëmundjeve të kafshëve dhe bimëve.

AUV synon që t'i unifikoj procedurat me autoritetet relevante ndërkombëtare në fushën e vet, për punë më efektive në fushën e MIK-ut.

6.3.3.4 Burimet njerëzore dhe trajnimi

Duhet të organizohen veprimtari trajnuese për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe veprimtaritë e kontrollit ndërkufitarë sipas një programi të paracaktuar dhe organizuar nga AUV në bashkëpunim me agjencitë homologe. Trajnimi i inspektorëve veterinarë dhe fitosanitar të PKK-dhe atyre të brendshëm duhet të përfshijë procedura në lidhje me bashkëpunimin ndërkufitar, sistemin e informacionit, gjuhët e huaja, etj. Trajnimi duhet të bazohet në një manual trajnimi, sipas kërkesave të legjislacionit të BE-së dhe të përfshijë një modul të trajnimit të përbashkët me homologët në vendet fqinje. Nevoja për gjuhën e duhur të trajnimit duhet të merret parasysh. Objektivi përfundimtar është siguri i burimeve njerëzore të aftë profesionalisht, prezent për çdo nivel që kërkon bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar. Janë organizuar trajnime ndërkombëtare në fushën e MIK në të cilat kanë marrë pjesë edhe zyrtarë të AUV.

Numri i kufizuar i stafit, mungesa e trajnimeve të mjaftueshme ndërkombëtare kanë ndikuar që niveli i bashkëpunimit ndërkombëtar të mos jetë i kënaqshëm.

Objektiv i AUV-së është organizimi i trajnimeve si dhe unifikimi i planeve të trajnimit me vendet tjera.

6.3.3.5 Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave

Komunikimi i hapur dhe aktiv duhet të vendoset në të gjitha nivelet ndërmjet AUV dhe shërbimeve homologe të vendeve fqinje. Takimet do të planifikohen në mënyrë periodike me qëllim që të identifikohen pika ndërkombëtare kontakti për të lehtësuar një komunikim efikas për rreziqet, komunikimin e efektshëm të rreziqeve në lidhje me shëndetin publik dhe të kafshëve, ndryshime në legjislacion dhe organizim të inspektimit kufitar.

Duhet të shkëmbehen informacione dhe rekomandime në legjislacion, rreziqe, sistemet e paralajmërimit të hershëm nga BE dhe organizatat ndërkombëtare (Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve IOE, dhe Organizata Botërore për Ushqimin FAO) etj.

Aktualisht AUV komunikon me autoritetet relevante ndërkombëtare në forma të raportimit të rasteve të paraqitjes së sëmundjeve, shkëmbimit të informatave nëpërmjet postës elektronike dhe të shkruar të cilat kanë të bëjnë me rastet e paraqitjes së sëmundjeve shtazore-bimore dhe rreziqet e tjera.

Komunikimi nuk është i rregullt dhe nga një herë për shkak të vonesës në komunikim krijohen vështirësi në kontrollin kufitar nga fusha e veterinarisë.

Objektiv i AUV-së është avancimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informatave me të gjitha autoritetet kompetente të rajonit dhe më gjerë, duke i respektuar dispozitat ligjore nga kjo fushë.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtij parametri luan edhe teknologjia informative. Aktualisht po punohet që PIK të kenë qasje në një rrjet të përbashkët të teknologjisë së lartë të informacionit dhe në intranet, sepse PK nuk kanë outlook. Për të siguruar qasje të shpejtë në informacion, duhet të vendoset një sistem modern dhe i standardizuar pajisjesh, e cila do të mundësojë qasje në bazën e të dhënave ndërkombëtare. Sistemi teknologjik do të mundësojë përdorimin e sistemit TRACES në një fazë të dytë.

Objektiv i AUV-së është integrimi i sistemeve aktuale hap drejt SINGLE WINDOW.

6.3.3.7 Infrastruktura dhe pajisjet

Bashkëpunimi ndërmjet vendeve fqinje lehtësohet nga infrastruktura dhe pajisjet në PIK, duke lejuar një regjim të barabartë të inspektimit kufitar në të dyja anët e kufirit. Në veçanti, duhet të harmonizohen kapaciteti dhe kategoritë e PKK. Mjediset dhe vendinspektimet kufitare duhet të përmbushin kërkesat dhe standardet e BE-së në lidhje me madhësinë dhe funksionet e tyre. Atje ku ambientet mungojnë, hapësira të përkohshme duhet të unifikohen me PIK të përbashkëta me mundësi aplikimi “një ndalje një kontroll”.

AUV momentalisht nuk ka objekte të veçanta në PIK dhe posedon vetëm me nga një zyrë brenda objekteve të PK-së ose DK-së.

Objektiv i AUV-së për të ardhmen është që të ndërtohen objekte të përbashkëta me qëllim të zbatimit të kontrollit të përbashkët ”një ndalje një kontroll”.

KAPITULLI

VI

7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E VIZAVE, AZILIT DHE MIGRIMIT NË KONTEKSTIN E MIK-ut

Autoritetet përgjegjëse në fushën e vizave, azilit dhe migracionit nuk janë të përfaqësuara domosdoshmërisht në kufi, kështu që bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në fushën e vizave, azilit dhe migracionit dhe agjencive përgjegjëse të kufirit duhen të jenë qartë të definuar.

7.1 VIZAT NË KONTEKST TË MIK-ut

Vizat janë të parapara me Ligjin për të Huajt (Nr 04/L- 069) në kapitullin III. Në këtë kapitull parashihet: lëshimi i vizave, llojet e vizave, vlefshmëria dhe vazhdimi i vizave. Projektligji në fjalë është inkorporuar në programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2013. Projektligji është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në datën 9.07.2013.

Pas vlerësimit të rekomandimeve nga Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2012 dhe Raportit të Komisionit Evropian të datës 8 shkurt 2013 lidhur me përmbushjen e kritereve të udhërrëfyesit për liberalizim të vizave ka konkluduar se duhet të hartohet Projektligji i ri për të Huajt. Në këtë kuadër është duke u hartuar Projektligji i ri për të Huajt, i cili është duke u harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe me aktet tjera ndërkombëtare.

Procedura për lëshimin e vizave në pikat e kalimit kufitar është e rregulluar me UA Nr. 21/2010 – MPB – Për lëshimin e vizave në pikat e kalimit kufitar ku pas hyrjes në fuqi të ligjit për të Huajt do të ndryshohet dhe plotësohet në përputhje me Ligjin për të Huajt. ndërsa procedura për lëshimin e vizave për të huajt nga Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës është e rregulluar me UA mbi Procedurat për lëshimin e vizave për të huajt nga Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës i cili është miratuar në dhjetor 2012. Gjithashtu në proces të miratimit gjindet Udhëzim Administrativ për rregullimin e Sistemit të Informatave për Viza të Kosovës (SIVK)

Deri në datën 1 Korrik 2013, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), ka zbatuar procedurën për vizitorë në bazë të se cilës të huajt duhen paraprakisht përmes garantuesit të tyre të paraqesin një seri dokumentesh para ardhjes në Republikën e Kosovës, dhe të marrin aprovimin për leje hyrje në Divizionin për të Huajt, Viza dhe Leje qëndrim në DSHAM-MPB. Kjo procedurë është zbatuar për shtetasit e shteteve me të cilat BE aplikon regjim të vizave, me përjashtim të vendeve me të cilat Republika e Kosovës ka marrëveshje bilaterale për lëvizje të ndërsjelle.

Me vendimin Nr. 01/108, të datës 14.12.2012, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur regjimin e vizave për 87 shtete. Ky vendim ka filluar të zbatohet qenga 1 korriku 2013. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën I të bashkëngjitur vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës para se të hyjnë në Republikën e Kosovës pajisen me viza hyrese në misionet diplomatike dhe konsullore në Republikën e Kosovës ose siç përcaktohet me procedurat tjera të zbatueshme.

Leshimi i nje vize ne kufi per shtetasit e shteteve te listuara ne Shtojcen I te vendimi te qeverise eshte perjashtim nga rregulli i pergjithshem, sipas te cilit viza leshohet nga misionet diplomatike apo konsullore pergjegjese.

Republika e Kosovës duhet të fillojë me zbatimin e politikave që kanë të bëjë me regjimin e vizave dhe dokumentet e tjera përkatëse, duke përfshirë përdorimin e biometrisë, në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe standardet evropiane.

Harmonizimi i kornizës ligjore i të gjitha institucioneve që janë të përfshira në procedurat e lëshimit të vizave për të huajt bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Trajnimi i personelit që ka të bëjë me të gjitha çështjet që kanë lidhje me lëshimin e vizave të huajve që aplikojnë për të hyrë në Republikën e Kosovës.

Teknologjia e duhur informative e sigurt, në mënyrë që të lëshojnë viza në kohë të shkurtër dhe të identifikojnë dokumentet false si dhe të themelohet baza e të dhënave për vizat në përputhje me Acquis të BE/Shengen.

7.2 AZILI DHE MIGRIMI NË KONTEKST TË MIK-ut

Nga pikëpamja institucionale, Republika e Kosovës ka krijuar organet përkatëse të cilat janë përgjegjëse për zbatimin legjislacionit përkatës në fushën e azilit, të huajve, të shtetësisë, të kthimit dhe të ri-pranimit.

Çështjet e Azilit janë përgjegjësi e Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion në kuadër të MPB-së/Divizioni i Azilit, që vepron në kuadrin e Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion (DSHAM) të MPB-së është organ përgjegjës për procedurën e azilit dhe përcaktimin e statusit të refugjatit. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj që vepron në kuadër të Policisë kufitare është përgjegjëse për zhvillimin e procedurës fillestare për azilkërkues e cila përfshin: parashtrimin e kërkesës, zhvillimin e intervistës fillestare, marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, marrja e fotografive edhe dërgimin e tyre në Qendrën e Azilit.

Po ashtu, DMH është përgjegjëse për egzekutimin e vendimit për depërtimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm Republika e Kosovës. Brenda DSHAM, funksionon edhe Divizioni për Kthim dhe Ripanim i cili merret me trajtimin e kërkesave për ripanim, parashtruara nga shtetet me të cilat Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje bilaterale për ripanim, apo kërkesa të parashtruara në bazë të Ligjit për Ripanim. Gjithashtu, divizioni në fjalë ndërmerr veprimet procedurale së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj për kthimin në vendin e origjinës të personave të cilët nuk përmbushin apo nuk

përbushin me kushtet për qëndrim në Republikën e Kosovës, pas përfundimit të procedurës administrative apo gjyqësore.

Me qëllim të kthimit të këtyre personave në mënyrë efektive dhe të sigurte drejt vendit të origjinës, të prejardhjes apo të tranzitit, është i nevojshëm hartimi i PSO-ve në mënyrë që të përcaktohen format e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të organeve përgjegjëse për çështjet e azilit dhe të huajve. Gjithashtu, duhet të bëhet trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarëve të DSHAM dhe zyrtarëve të Policisë Kufitare-DMH për zbatimin e Ligjit të Azilit dhe Ligjit të Huajve si dhe të praktikave më të mira të BE.

Divisioni për të huaj është përgjegjës për zbatimin e dispozitave ligjore që rrjedhin nga legjislacioni për të huaj lidhur me qëndrimin e tyre. Në të njëjtën kohë, Divisioni për të huaj është përgjegjës për verifikimin e personave që aplikojnë për vize si dhe për zgjatjen e visës brenda Kosovës (kontrollimin e bazës së të dhënave për të verifikuar se personat që aplikojnë për vizë janë subjekt i largimit me forcë, depërtimit, refuzimit të leje qëndrimit dhe azilkërkimit apo verifikimit të shkeljeve eventuale të legjislacionit për të huaj). Kjo duhet të bëhet në koordinim me Policinë e Kosovës si dhe MPJ-në. Për rrjedhojë, është edhe domosdoshme dhe ngritja e kapaciteteve në DSHAM me qëllim të kryerjes së këtyre detyrave. për verifikimin e sigurisë të personave që aplikojnë për vizë.

KAPITULLI

VII

8. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RISHIKIMI

Në mënyrë që të përcaktohet sukcesi i planit të veprimit dhe që ai t'i përshtatet ndryshimeve të rrethanave, prioritetëve dhe situatave, të gjitha elementet do të jenë subjekt i monitorimit, vlerësimit dhe rishikimit në baza të rregullta. Bazuar në rezultatet e këtyre analizave, veprimet dhe aktivitetet do të përshtaten ose objektivat do të riformulohen apo shtohen.

Gjithashtu, strategjia do të rishikohet në intervale të rregullta.

Monitorimi

Rekomandohet që të përpilohen raporte të rregullta monitoruese ku do të përmblihet përparimi që është bërë. Trupi monitorues do të monitorojë zbatimin e planit të veprimit, zbatimin e aktiviteteve, arritjen e rezultateve, shpenzimet e bëra, burimet e shfrytëzuara dhe rreziqet e mundshme. Kjo do të arrihet nëpërmjet një procesi të mbledhjes së vazhdueshme, sistematike dhe analizave të mirëfillta të informacioneve dhe të dhënave (takime, raporte të aktiviteteve, etj), nga agjencitë e përfshira në MIK. Kjo ndihmon për të vlerësuar nëse qëllimet e vendosura janë arritur ose janë afër që të arrihen dhe kjo gjithashtu ndihmon mëpastaj për një vendimmarrje sa më efektive.

Vlerësimi

Vlerësimi përfshinë një vlerësim të efikasitetit, efektivitetit, ndikimit, lidhjen dhe qëndrueshmërinë e planit të veprimit dhe strategjisë. Kur do që të bëhet vlerësimi, informacioni i njëjtë është relevant që është përdorur për monitorim, por me një fokus të ndryshëm dhe të plotësohet me informata shtesë. Qëllimi i vlerësimit është që të merret një pamje më globale e përparimit të bërë në zbatim. Kjo bëhet duke krahasuar rezultatet me objektivat e planit të veprimit dhe strategjisë, duke mos qenë të përqëndruar vetëm te numri i objektivave që janë përmbushur, por edhe në cilësinë e rezultateve të arritura. Vlerësimet duhet të kryhen në intervale periodike, p.sh. në mes të përmbushjes së aktiviteteve dhe pas përmbushjes së tyre. Rekomandohet që në këtë proces të përfshihen ekspertë të jashtëm, të cilët janë të pavarur.

Rezultatet e vlerësimit duhet të përdoren për të përfshirë mësimet e nxjerra në procesin e zbatimit, për të paraqitur ndryshimet e mundshme dhe për të marrë parasysh mundësinë e ndryshimit të procedurave (politikës). Raportet e vlerësimit mund të shërbejnë si bazë për procesin e ardhshëm vendimmarrës.

Rishikimi

Të dyja rezultatet e vlerësimit dhe monitorimit të dhënave janë të nevojshme për rishikimin e planit të veprimit dhe strategjisë. Dokumenti i strategjisë nuk duhet të rishikohet shumë shpesh në krahasim me planin e veprimit, përderisa strategjitë kombëtare janë krijuar zakonisht për të mbuluar një afat më të gjatë deri në pesë vjet. Megjithatë, në qoftë se situata në vend apo politika kombëtare lidhur me menaxhimin e kufijve ndryshon në mënyrë drastike, disa objektiva në

strategji (dhe si rrjedhojë plani i veprimit) duhet të rishikohen. Strategjia duhet të rishikohet periodikisht, për shembull, çdo tre deri në katër vjet, dhe plotësohet dhe ndryshohet (amendamentohet) në përputhje me rrethanat ku duhet të reflektoj prioritetet dhe zhvillimet kombëtare. Plan i veprimit duhet të rishikohet mundësisht çdo vit, por më së largu çdo dy vite.

Nëse vlerësimi pasqyron se disa aktivitete nuk kanë çuar në rezultatet e pritshme, do të jetë e nevojshme që të rishikohen gjithashtu edhe veprimet apo objektivat. Hapi i parë **për trupin zbatues** është të identifikojnë (rendisin) plotësimet e nevojshme ose fshirjet e pjesëve nga strategjia dhe plani i veprimit.

Ky dokument duhet të merr aprovimin paraprak të organit mbikëqyrës dhe vendimmarrës, të cilët pastaj mund t'i kërkojnë organit implementues për të përpunuar një version të ri të këtyre dy dokumenteve.

Shtojcat

Strukturat organizative të Agjencive të MIK-ut

- PK Shtojca 1
- DK Shtojca 2
- AUV Shtojca 3

Struktura e bashkëpunimit dhe bashkërendimit
për MIK Shtojca 4

Korniza Ligjore, shtojca 5


Lista e shteteve që kërkohet vizë për të hyrë në
RKS Shtojca 6

SHTOJCA 1

Struktura organizative e Policisë Kufitare




SHTOJCA 2:
Struktura organizative e Doganës së Kosovës 2013




SHTOJCA 3

Struktura Organizative e AUV-së



SHTOJCA 4

Struktura e bashkëpunimit dhe bashkërendimit për MIK



SHTOJCA 5

Korniza Ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror
3. Ligji nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës
4. Ligji nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës
5. Ligji nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës
6. Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë - Ligji nr. 03/L-089 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë
7. Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit
8. Ligji nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit
9. Kodi i Penal i Kosovës
10. Kodi i Procedurës Penale
11. Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
12. Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
13. Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit
14. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë
15. Ligji nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit -Ligji nr. 03/L-217 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit
16. Ligji nr. 02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin
17. Ligji nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave
18. Ligji nr. 03/L-99 për Letërnjoftimin
19. Ligji nr. 02/L-118 për Emrin Personal
20. Ligji nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor
21. Ligjin nr. 04/L-069) për të Huajt
22. Ligji nr. 03/L- 073 për Azilin- Ligji nr. 03/L-089 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Azil
23. Ligji nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës - Ligji nr. 04/L-059 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës
24. Ligji nr. 03/L-136 për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës
25. Ligji nr. 03-L-143 për Armët
26. Ligji nr. 03-L-232 për Tregtinë e Mallrave Strategjike
27. Ligji nr. 03-L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje përkatëse të sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri
28. Ligji nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve
29. Ligji nr. 03/ L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
30. Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë
31. Ligji nr. 03/L-109 Kodi Doganor dhe i Akcizave
32. Ligji nr. 04/L-048 për Tregti me Jashtë
33. Ligji nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe
34. Ligji nr. 03/L-170 për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
35. Ligji nr. 02/L-33 për Investimet e Huaja
36. Ligji nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar
37. Ligji nr. 2004/2 për Veterinarinë

38. Ligji nr. 02/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse
39. Ligji nr. 02/L-10 për Përkujdesjen ndaj Kafshëve
40. Ligji për Produktet Medicinale Veterinare
41. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve
42. Ligji ne 2003/26 për Produktet Medicinale dhe Pajisjet Medicinale
43. Ligji nr. 03/L-016 për Ushqimin
44. Ligji nr. 02/L-095 për Mbrojtjen e Bimëve
45. Ligji nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve
46. Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
47. Ligji nr. 03/L-119 për Produktet Biocide dhe shtojca e ligjit
48. Ligji nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve
49. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike dhe Substancat Psikotrope dhe Prekursor
50. Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina
51. Ligji nr. 02/L-116 për Kimikate
52. Ligji nr. 03/L – 033 për Statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj
53. Ligji nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
54. Ligji nr. 03/L-104 për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-Jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare
55. Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
56. Ligji nr. 2004/6 për Transportin e Mallrave të Rrezikshëm
57. Ligji nr. 02/L-103 për Pajisjet nën Presion
58. Ligji nr. 2004/1 për Transportin Rrugor -Ligji nr. 02/L-127 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor dhe

Të gjitha ligjet dhe direktivat e BE-së dhe ata ndërkombëtare lidhur me:

- Kontrollin kufitar,
- Kontrollin doganor,
- Inspektimin e bimëve dhe produkteve bimore,
- Inspektimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe ushqim dhe ushqim me origjinë jo shtazore,
- Kontrollimin e shëndetit të njerëzve,
- Azilin dhe format e tjera të mbrojtjes ndërkombëtare,
- Migrimin,
- Vizat dhe dokumentet e identitetit,
- Mbledhjen e informacionit,
- Mbrojtjen e të dhënave,
- Anti-korrupsionin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/108
 Datë: 14.12.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-069 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012, mori:

V E N D I M

1. Vendoset regjimi i vizave për shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij Vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.
2. Shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij vendimi, para se të hyjnë në Republikën e Kosovës, pajisen me viza hyrëse për në Republikën e Kosovës në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.
3. Lëshimi i një vize në kufi për shtetasit e shteteve të listuara në Shtojcën I të këtij vendimi është përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas të cilit viza lëshohet nga misionet diplomatike apo konsullore përgjegjëse.
4. Shtetasit e shteteve të listuara në shtojcën I të këtij vendimi, lirohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë hyrëse për në Republikën e Kosovës, në rast se posedojnë vizë të vlefshme shumë-hyrëse *Schengen*. Këta persona mund të qëndrojnë në Republikën e Kosovës për një periudhë prej pesëmbëdhjete (15) ditëve.
5. Regjimi i vizave nuk zbatohet për poseduesit e dokumenteve të udhëtimit të Kombeve të Bashkuara, për të huajt për aq kohë sa statusi i tyre rregullohet me Ligjin nr.03/L-033 për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe konsullore, personelit të tyre, të pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe personelit të tyre në Republikën e Kosovës.
6. Ky vendim nuk paragjykon detyrimet që dalin nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera në lidhje me zbatimin e regjimit të vizave ose vizave për kategori të caktuara.

7. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme, që në afat prej tre (3) muaj nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, të harmonizojnë dhe të miratojnë dhe kornizën e nevojshme ligjore për procedurat e lëshimit të vizave për të huaj, në pajtim me legjislacionin e BE dhe *aquis communautaire*.
8. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe fillon së zbatuari nga data 1 korrik 2013.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I:

1. Afganistani;
2. Algjeria;
3. Angola;
4. Armenia;
5. Azerbajxhani;
6. Bangladeshi;
7. Bjellorusia;
8. Bregu i Fildishtë
9. Benini;
10. Bolivia;
11. Burkina Faso;
12. Burundi;
13. Butani;
14. Çadi;
15. Egjipti;
16. Ekuadori;
17. Eritrea;
18. Etiopia;
19. Filipinet;
20. Gaboni;
21. Gambia;
22. Gana;
23. Guinea Ekuatoriale;
24. Guinea;
25. Guinea-Bisau;
26. Gjeorgjia;
27. Haiti
28. India;
29. Indonezia;
30. Iraku;
31. Irani;
32. Jemeni;
33. Kamboxha;
34. Kameruni;
35. Kape Verde;
36. Kazakistani;
37. Kenia;
38. Kirgistani;
39. Kina;
40. Kuba;
41. Laosi (Republika Popullore Demokratike e);
42. Lebanoni;
43. Liberia;
44. Libia;
45. Madagaskari;
46. Majanmari;
47. Mali;
48. Maroku;
49. Mauritania;

50. Moldavia;
51. Mongolia;
52. Mozambiku;
53. Nepali;
54. Nigeri;
55. Nigeria;
56. Pakistani;
57. Peru;
58. Republika Dominikane;
59. Republika Demokratike e Kongos;
60. Republika e Afrikës Qendrore;
61. Republika e Kongos;
62. Republika Popullore Demokratike e Koresë;
63. Ruanda;
64. Rusia;
65. Senegali;
66. Siera Leone;
67. Siria;
68. Somalia;
69. Sudani;
70. Sudani Jugor
71. Surinami;
72. Shri Lanka;
73. Tajlanda;
74. Tanzania;
75. Taxhikistani;
76. Togo;
77. Tunizia;
78. Turkmenistani;
79. Uganda;
80. Ukraina;
81. Unioni i Komoreve;
82. Uzbekistani;
83. Vietnami;
84. Xhamajka;
85. Xhibuti;
86. Zambia;
87. Zimbabve.